

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5903
E hënë, 14 tetor 2019
çmimi 0.40 €

Rexhep Selimi: I gjithë procesi i dialogut me Serbinë ka qenë gabim

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALI BERISHA ■ FAQE 4-5

REZULTATI ZGJEDHOR NUK KA QENË I PRITSHËM PËR NE



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ali Berisha, e ka quajtur të papritshëm rezultatin e kësaj partie në zgjedhjet e 6 tetorit. Ai ka thënë se koalicioni AAK-PSD ka pritur rezultat shumë më të mirë bazuar në punën e qeverisë Haradinaj. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se çështjet prioritare për popullin e Kosovës, sidomos zhvillimi ekonomik dhe punësimi, kanë qenë determinuese për rezultatin zgjedhor. Ai ka thënë se AAK-ja do të jetë parti opozitare dhe do të luajë rol konstruk-

tiv. Sipas Berishës, AAK-ja do të jetë kujdestare e moscenimit të interesave nacionale, sidomos ndaj mosndryshimit të kufijve, moskrijimit të asociacionit me rol ekzekutiv dhe ndaj aspekteve të tjera që e bëjnë jofunksionale Kosovën

Hospitalizohen nëntë persona pas kontaktit me zarfet e votave nga Serbia

Nëntë persona, të gjinisë femërore, kanë kërkuar të dielën ndihmë mjekësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) pas kontaktit që kanë pasur me zarfet e votave të ardhura nga Serbia. Me të filluar numri i këtyre votave, të cilat kanë qenë të vendosura në hapësirën e ndërtesës së Ministrisë së Infrastrukturës, zyrtarëve që kanë prekur zarfet u është shkaktuar alergji në duar. Dyshimet e para janë për një helmim, por zyrtarët shëndetësorë ende nuk kanë bërë me dije se për çfarë reaksioni alergjik bëhet fjalë ■ FAQE 3



Pasojat e largimit të Kosovës nga Asociacioni Evropian për Cilësi në Arsim

FAQE 7



OPINION

PËR ÇMIMIN NOBEL DHE GJENOCIDIN

F. 13

Nga Bedri ISLAMI



AKTUALE



NUK KANË TË NDALUR SUKSESET E UNIONIT NË GJERMANI

F. 13

POLICIA DHE DOGANA IDENTIFIKOJNË 23 AUTOMJETE QË I JANË SHMANGUR TARIFAVE DOGANORE

F. 8

NESËR NË KRYEQYTET FILLON PROCESI I ELIMINIMIT TË BREJTËSVE

F. 10

EKONOMI

MINISTRIA E BUJQËSISË KRIJON DEPARTAMENT TË VEÇANTË PËR VRESHTARËT DHE VERËTARËT

F. 8

KOSNETTI TAKON FERMERËT: FUQIA MË E MADHE E KOSOVËS ËSHTË POPULLI

F. 9

KULTURË

"ARMAGEDONI" PËRUIROI LIBRAT E SHALËS DHE TË OLLURIT

F. 14-15

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Basha: Nuk shkohet në Evropë me një kryeministër hajdut!

TRIANË, 13 TETOR - "Nuk shkohet në Evropë me një kryeministër hajdut", kështu tha kreu i opozitës Lulzim Basha në fjalën e tij para banorëve të Unazës së Re. "Një e keqe e madhe i ka bërë bashkë qytetarët, që ka zaptuar vatrat e familjeve në Unazën e Re. Qindra vogëlushe janë në tmerr pasi prindërit nuk e dine në se do e kenë një strehë mbi kokë", tha Basha më tej. Kreu i opozitës nuk i kurseu akuzat ndaj qeverisë. "40 milionë euro u vodhën me aferën Unaza e Re, u ndryshua rrjedha e Lanës që të ndërtonte miku i Balles dhe Ramës. Shikoni policët, edhe ata janë prindër,

por në vend që të shërbejnë ligji, i shërbejnë sot antiligjit, i cili ka urdhëruar arrestimin e disa personave.

Balla është mundësuesi i pastrimit të qindra milionë eurove të toyota yaris. Tahiri e ktheu Shqipërinë në hambar droge. Në një vend ku kriminelët janë të lirë e baballarët në burg ky vend nuk e ka vendin në Evropë. Nuk shkohet në Evropë me një kryeministër hajdut narkotrafiknat dhe pa zgjedhje të lira. Shqipëria si Evropa është thirrja e çdo demokraci, është urdhëresa më e shenjtë për opozitën e bashkuar, ndaj sonte luftojmë për gjëra të shenjta që na

bashkojnë, për fëmijët tanë, për shenjtërinë e banesës, ligjin.

Luftoni për fëmijët tuaj. Mos të presim që e keqja t'i tmerrojë fëmijët tuaj, po të rrimë e këtu e ta luftojmë atë. Dështimi i sotëm mban vulën e Edi Ramës. Shkaktari i aferës në Unazën e Re, ai që po i mbyll dyert Shqipërisë. Kjo nuk është një betejë për pushtet, por për t'i dhënë fund regjimit të hajdutëve, t'i japim fund një transicioni të tmerrshëm. Koha kur Shqipëria po ecën indietro po merr fund, 6 muaj më parë shumë kush nuk besoi, por sot Evropa flet me gjuhën e qytetarëve që duan ndryshim", tha Basha.



Këshilli Evropian propozon hapjen me kushte të negociatave me Shqipërinë

Në draft-konkluzionet thuhet se Këshilli Evropian do të propozojë hapjen me kushte të negociatave me Shqipërinë dhe kushtet e vendosura ngjasojnë me ato të Berlinit zyrtar, përpara se te jepte "Po"-në në Bundestag

PRISHTINË, 13 TETOR - Këshilli Evropian do të propozojë hapjen me kushte të negociatave me Shqipërinë. Kështu thuhet në draft-konkluzionet e Këshillit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Kushtet e vendosura në draft, ngjasojnë me ato të Berlinit zyrtar, përpara se te jepte "Po"-në në Bundestag.

Në thelb, kushtet lidhen me reformën në drejtësi dhe reformën zgjedhore. "Këshilli Evropian vendos të hapë negociatat e pranimit me Shqipërinë. Para konferencës së parë ndërqeveritare, e cila duhet të zhvillohet jo më vonë se në gjysmën e parë të vitit 2020, në varësi të progresit të bërë, Shqipëria

duhet të sigurojë: Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, nisjen e hetimeve ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të dyshuar për sjellje kriminale si rezultat i gjetjeve nga procesi i vetting-ut, hetim rasteve dhe akuzave për krim elektoral, ngritja dhe funksionimi i SPAK-ut, rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë, të miratohet reformën zgjedhore në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR, të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese për zgjedhjet lokale të 30 qershorit 2019.

Por ndërsa Shqipërisë i kërkohen



të gjitha këto, Këshilli inkurajon klasën politike të zgjidhë ngërçin politik. "Partitë e opozitës duhet të rindërtojnë në mënyrë konstruktive në institucionet demokratike. Të gjithë aktorët politikë duhet të angazhohen në

axhendën e reformës në BE dhe të dialogojnë për të kapërcyer polarizimin politik", shkruhet në draftin e konkluzioneve të Këshillit të siguruar nga mediet. Një nga vendet skeptike e cila kërkon shtyrjen e negociatave

për Shqipërinë, është Franca. Të dielën presidenti francez dhe kancelarja gjermane, do të zhvillojë një takim, të cilin DË e ka quajtur shansin e fundit për të ndryshuar qëndrimin e Francës. Diskutimi për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut nis nesër (e martë) në takimin e ministrave të BE-së. Vendimi për hapjen ose jo të negociatave për Shqipërinë do të jepet më 18 tetor. Më 27 shtator Parlamenti gjerman votoi pro hapjes së negociatave të Shqipërisë me BE-në. Nga ana tjetër Holanda ka lënë hapur derën për Shqipërinë duke deklaruar se hapja e negociatave për Shqipërinë është e parakohshme, por nuk do ketë veto bllokuese nga ana e saj. Franca kërkon shtyrjen e një vendimi për hapjen e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në mbledhjen e javës së ardhshme të Këshillit Evropian.

Të drejtat e minoritetit, kushti i Greqisë për negociatat



TRIANË, 13 TETOR - Në një intervistë për gazetën "Kathimerini" ministri i Jashtëm grek Nikos Dhenias ka ripërsëritur se një prej kushteve kryesore që kërkon Athina ndaj Tiranës për të mbështetur fillimin e negociatave me BE-në janë të drejtat e minoritetit grek në Shqipëri. "Flasim ndershmërisht me Shqipërinë. Kërkojmë mbrojtjen e të drejtave të pakicës greke. Ne nuk kemi pretendime për Shqipërinë. Greqia është një faktor i stabilitetit dhe sigurisë së kufijve. Sidoqoftë, Shqipëria

duhet të kuptojë që ecuria e saj evropiane përmban mbrojtjen e te drejtave dhe parimeve evropiane, të cilat sigurojnë mbrojtjen e pakicave. Kërkon gjithashtu respektimin e pasurive të tyre. Dhe nuk ka mundësi që pasuritë në zonën bregdetare të Himarës të mos jenë objekt që duhet mbrojtur", tha kryediplomati grek. Sipas tij Greqia tashmë është rikthyer dhe ka për të luajtur një rol të madh dhe pozitiv në Ballkan duke ndihmuar partnerët e saj në BE, Bullgarinë dhe

Rumaninë të cilat janë jashtë Shengenit dhe dëshirojnë të anëtarësohen.

Por edhe sa i përket Ballkanit Perëndimor, Dhenias ka thënë se Greqia duhet të luajë një rol udhëheqës dhe stabilizues, në mënyrë që ky rajon të mund të fitojë një perspektivë evropiane duke ushtruar edhe ndikimin e saj pozitiv pasi edhe pse Greqia ka qenë në krizë ekonomike tashmë ajo është rimëkëmbur dhe PBB i saj është shumë më i madh se i disa vendeve ballkanike së bashku.

Dyshohet se janë helmuar 26 zyrtarë që kanë qenë të ngarkuar me numërimin e votave në zarfe të ardhura nga Serbia

Hospitalizohen nëntë persona pas kontaktit me zarfet e votave nga Serbia



Nëntë persona, të gjinisë femërore, kanë kërkuar të dielën ndihmë mjekësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) pas kontaktit që kanë pasur me zarfet e votave të ardhura nga Serbia. Me të filluar numri i këtyre votave, të cilat kanë qenë të vendosura në hapësirën e ndërtesës së Ministrisë së Infrastrukturës, zyrtarëve që kanë prekur zarfet u është shkaktuar alergji në duar. Dyshimet e para janë për një helmim, por zyrtarët shëndetësorë ende nuk kanë bërë me dije se për çfarë reaksioni alergjik bëhet fjalë

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 TETOR - Procesi i verifikimit të votave të ardhura nga Serbia është ndërprerë të dielën pasi që zyrtarëve të cilët kanë qenë në kontakt me zarfet me votat e qytetarëve nga Serbia u është shfaqur alergji në duar. Si pasojë, nëntë persona kanë kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Megjithatë, ende nuk është bërë e qartë se për çfarë reaksioni alergjik bëhet fjalë. Lajmin për dyshimet e helmimit në hapësirën e ndërtesës së Ministrisë së Infrastrukturës, ku kanë qenë të vendosura zarfet, fillimisht e ka bërë me dije Besnik Buzhala nga Divizioni i Shërbimit Votues, duke thënë se 26 personave që kanë qenë duke i verifikuar votat u është paraqitur alergji nëpër duar nga zarfet që kanë ardhur nga Serbia.

Më pas, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) përmes një komunikatë për

media ka treguar simptomat e pacientëve. "Në orën 11:58 në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare janë lajmëruar 9 pacientë të gjinisë femërore, dy prej tyre shtatzënë, me kuarje të duarve të intensitetit të ulët. Dy nga to kanë pasur edhe vjellje. Të gjitha kishin ndjenjë diskomforti dhe frikë. Tek të gjitha rastet nuk ka pasur sindromë infektive dhe gjendja e përgjithshme është stabile", është thënë në komunikatën e QKUK-së.

Sipas kësaj komunikate, pacientët pohojnë se menjëherë pas hapjes së zarfeve brenda në kuti të votimeve kanë ndjerë aromë kundërmuese. "Ekipi kujdestar i Klinikës Infektive ka ndërmarrë masat e duhura duke i spitalizuar dhe duke ua ofruar ndihmën e duhur mjekësore. Konziliumi i ShSKUK dhe Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike në vazhdimësi janë duke e monitoruar gjendjen shëndetësore të pacientëve të spitalizuar", është theksuar në komunikatën e

QKUK-së.

Ndërsa drejtori i Institutit të Shëndetit Publik, Naser Ramadani, ka thënë se nevojiten 24 deri në 48 orë për ta vërtetuar gjendjen e shëndetit të pacientëve. Ai ka thënë për medie se gjendja e pacientëve është stabile dhe janë duke u bërë të gjitha analizat e nevojshme. "Janë lajmëruar nëntë persona. Gjendja e tyre është stabile. Ekipet kujdestare kanë ndërmarrë masat e duhura rreth këtij rasti. Jemi duke bërë analizat që të kuptojmë se nga ka ardhur helmimi", ka thënë Ramadani.

Kjo ngjarje ka nxitur reagues të ndryshme. Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka kërkuar nga autoritetet shtetërore që t'i hetojnë shkaqet e këtij helmimi. "Autoritetet shtetërore duhet të hetojnë shkaqet e këtij helmimi ashtu siç duhet t'i hetojnë pakot e ardhura nga Serbia në mënyrë të organizuar nga shteti i Serbisë. Këto pako me fletëvotime nuk kanë ardhur përmes postës, ashtu siç e kërkon ligji për zgjedhje, por janë sjellë kundërligjshëm nga zyra ndërlidhëse e Serbisë. Këto fletëvotime të sjella kundërligjshëm duhet të refuzohen", është thënë në reagimin e LV-së, duke shtuar se shërbimi profesional i KQZ-së duhet ta vazhdojë punën në vlerësimin dhe numërimin e saktë të votave të ardhura nga mërgata. "Pakot me fletëvotime të dërguara nga bashkatdhetarët, e të cilat janë verifikuar dhe vlerësuar, duhet të dërgohen në Qendrën e Numërimit

dhe të Rezultateve për t'u numëruar", është thënë në reagimin e Lëvizjes Vetëvendosje.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq dhe Lista Serbe, pas lajmit për shkaktimin e alergjisë nga zarfet e ardhura nga Serbia, thanë se kjo është tendencë për ta paralajmëruar opinionin vendës dhe ndërkombëtar se po përgatitet manipulimi i votave serbe në Kosovë. Sipas tyre, kjo gjë ka për qëllim ta dëmtojë vullnetin e popullit serb. Pas numërimit të votave të rreg-

ullta, tash kanë nisur të verifikohen votat e ardhura me postë nga vende të ndryshme, përfshirë këtu edhe qytetarët nga Serbia që janë regjistruar për të votuar në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të Kosovës, të mbajtura më 6 tetor.

Në Kosovë më 6 tetor u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Sipas rezultateve preliminare nga numërimi i votave të rregullta, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar më së shumti vota, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Kryeshefi i sekretariatit të KQZ-së: Do ta ofrojmë sigurinë maksimale që mos të preket integriteti i procesit zgjedhor

Kryeshefi ekzekutiv i sekretariatit të KQZ-së, Enis Halimi, ka vizituar vendin ku janë helmuar zyrtarët e KQZ-së, teksa ka theksuar se do ta ofrojmë sigurinë maksimale që mos të preket integriteti i procesit zgjedhor. Përveç kësaj, Halimi bëri me dije se bashkë me votat e ardhura nga Serbia janë edhe zarfet nga shtete të tjera. Ai ka thënë se KQZ-ja pritet të vendosë se si do të veprojë me tutje me këta zarfe. "Ende nuk e kemi situatën e qartë. Aty kanë ardhur zarfe nga shtete të tjera, por edhe nga Serbia.

Procesi i verifikimit ka vijuar gjatë këtyre ditëve. Po besoj më pastaj do të kemi një pasqyrë më të qartë për të gjitha këto pretendime që i kemi. Është çështje e vendimmarrjes së KQZ-së. Ju e dini se zarfi përbën material të ndjeshëm. Tashmë është në pronësi të KQZ-së. Ajo do të vendos se si do të veprojë me këtë material të ndjeshëm, por ne jemi të interesuar ta ofrojmë sigurinë maksimale në këtë material dhe mos të ketë prekje në integritetin e procesit zgjedhor", ka thënë Halimi.

Flet për "Epokën e re", Ali Berisha

Rezultati zgjedhor nuk ka



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ali Berisha, e ka quajtur të papritshëm rezultatin e kësaj partie në zgjedhjet e 6 tetorit. Ai ka thënë se koalicioni AAK-PSD ka pritur rezultat shumë më të mirë bazuar në punën e qeverisë Haradinaj. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka deklaruar se çështjet prioritare për popullin e Kosovës, sidomos zhvillimi ekonomik dhe punësimi, kanë qenë determinuese për rezultatin zgjedhor. Ai ka thënë se AAK-ja do të jetë parti opozitare dhe do të luajë rol konstruktiv. Sipas Berishës, AAK-ja do të jetë kujdestare e moscenimit të interesave nacionale, sidomos ndaj mosndryshimit të kufijve, moskrijimit të asociacionit me rol ekzekutiv dhe ndaj aspekteve të tjera që e bëjnë jofunksionale Kosovën

në punën që e ka bërë qeveria Haradinaj, sidomos në vendimet që ka marrë", ka deklaruar Berisha, duke shtuar se çështjet prioritare për popullin e Kosovës, sidomos zhvillimi ekonomik dhe punësimi, kanë qenë determinuese për rezultatin zgjedhor. "Partitë e tjera politike i kanë pasur në agjendën e tyre të potencuara këto çështje më tepër dhe nuk u kanë dhënë rëndësi aspekteve nacionale që për Aleancën dhe PSD-në kanë qenë shumë të rëndësishme. Pra, elektorati i Kosovës është përcaktuar për ato që nuk kanë qenë shumë të potencuara në programin e Aleancës", ka theksuar ai. Berisha ka thënë se Aleanca do të jetë parti opozitare dhe do të luajë rol konstruktiv. Sipas tij, AAK-ja do të jetë kujdestare e moscenimit të interesave nacionale, sidomos ndaj mosndryshimit të kufijve, moskrijimit të asociacionit me rol ekzekutiv dhe ndaj aspekteve të tjera që e bëjnë jofunksionale Kosovën. Berisha ka

bërë thirrje që sa më shpejt të formohen institucionet e reja, meqë Kosovën e presin shumë sfida. Sipas tij, dialogu me Serbinë do të jetë sfida kryesore e qeverisë së re.

"Epoka e re": Z. Berisha, si e vlerësoni në përgjithësi procesin zgjedhor të 6 tetorit?

Berisha: Procesi zgjedhor i 6 tetorit marrë në tërësi ka shkuar mirë. Ndonëse pritet tona kanë qenë të mëdha sa i përket rezultatit, procesi ka qenë i rregullt bazuar në vlerësimet e Aleancës. Bazuar në këtë nuk kemi kërkuar rinumërim të votave dhe përsëritje të votimeve pasi që mendojmë se kjo e komplikon situatën dhe për këtë arsye e kemi pranuar rezultatin zgjedhor ashtu qysh është.

"Epoka e re": Disa nga kandidatët për deputetë të koalicionit AAK-PSD janë ankuar se nuk ka shkuar mirë procesi i numërimit të votave, sidomos në garën e brendshme.

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 13 TETOR - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ali Berisha, ka thënë të dielën se në përgjithësi procesi zgjedhor i 6 tetorit ka qenë i mirë dhe i rregullt. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se Aleanca nuk ka kërkuar rinumërim të votave dhe përsëritje të votimeve pasi

që mendon se një gjë e tillë e komplikon situatën. "Procesi zgjedhor i 6 tetorit marrë në tërësi ka shkuar mirë. Ndonëse pritet tona kanë qenë të mëdha sa i përket rezultatit, procesi ka qenë i rregullt bazuar në vlerësimet e Aleancës. Bazuar në këtë nuk kemi kërkuar rinumërim të votave dhe përsëritje të votimeve pasi që mendojmë se kjo e komplikon situatën dhe për këtë arsye e kemi pranuar

rezultatit zgjedhor ashtu qysh është", është shprehur Berisha. Ai ka thënë se koalicioni AAK-PSD ka pritur rezultat shumë më të mirë bazuar në punën e qeverisë Haradinaj. "Pritjet e Aleancës nuk kanë qenë për këtë rezultat, mirëpo vlerësimi dhe verdikti i popullit ka qenë i tillë dhe ne do ta respektojmë atë. Vullneti i shumicës së qytetarëve ka përcaktuar që kësaj radhe AAK-ja të jetë në opozitë. Kemi pritur më shumë bazuar

qenë i pritshëm për ne



të jetë në opozitë. Kemi pritur më shumë bazuar në punën që e ka bërë qeveria Haradinaj, sidomos në vendimet që ka marrë. Mendoj se çështjet që janë prioritet i popullit të Kosovës, sidomos zhvillimi ekonomik dhe punësimi, kanë qenë determinuese që të vijë ky rezultat. Partitë e tjera politike i kanë pasur në agjendën e tyre të potencuara këto çështje më tepër dhe nuk u kanë dhënë rëndësi aspekteve nacionale që për Aleancën dhe PSD-në kanë qenë shumë të rëndësishme. Pra, elektorati i Kosovës është përcaktuar për ato që nuk kanë qenë shumë të potencuara në programin e Aleancës.

"Epoka e re": Cila mendoni se ka qenë arsyeja kryesore që nuk keni shënuar rezultat më të mirë në zgjedhje meqë pritjet i keni pasur të mëdha për të fituar?

Berisha: Aleanca në këto zgjedhje ka rritje të caktuar sidomos në disa zona në Dukagjin. Koalicioni i kaluar qeverisës ka qenë mjaft kompleks dhe ka qenë një qeveri megalomane. Bazuar në atë kompleksitet dhe vendimarrje të komplikuar nuk kanë mundur të realizohen ato që kanë qenë esenciale për popullin siç janë zhvillimi më i madh ekonomik, punësimi më i madh dhe aspektet e tjera. Qeveria Haradinaj ka marrë vendime shumë të mëdha dhe të rëndësishme sa i përket aspektit nacional, ndërsa në aspekte të tjera të brendshme ka qenë ndoshta jo shumë e kujdesshme, sidomos ndaj elektoratit të vet, pasi që preokupimi kryesor i kryeministrit dhe i qeverisë kanë qenë çështjet nacionale.

"Epoka e re": Bazuar në rezultatet preliminare AAK-ja do të jetë opozitë. Cili do të jetë roli i saj?

Berisha: Qytetarët kanë vendosur që Aleanca të jetë parti opozitare dhe këtë qëndrim të elektoratit e respektojmë. Si opozitë do ta luajmë rolin konstruktiv si gjithmonë. Do të jemi kujdestarë të moscenimit të interesave nacionale, sidomos ndaj moskrijimit të një asociacioni që ka rol ekzekutiv dhe ndaj aspekteve të tjera që e bëjnë jofunksionale Kosovën.

"Epoka e re": Herën e fundit kur AAK-ja ka qenë në opozitë ka bërë opozitë jokonstruktive, madje së bashku me Vetëvendosjen ka përdorur edhe gaz lotsjellës. Do të jetë e njëjta Aleancë edhe përballë

qeverisjes Kurti?

Berisha: Aleanca do ta luajë rolin e vet opozitar duke pasur për bazë mbrojtjen e interesave të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Për format e veprimtimit do të merren vendimet në organet e partisë, varësisht prej situatave të krijuara.

"Epoka e re": Si e shihni formimin e institucioneve të reja, mund të ketë vonesa në këtë drejtim?

Berisha: Situata aktuale në Kosovë nuk lejon vonesa dhe ata që e kanë marrë besimin e qytetarëve duhet të fillojnë sa më shpejt negociatat për

formimin e qeverisë së re të cilën e presin shumë sfida. Kosova sa më parë duhet t'i ketë institucionet e reja të dala nga vullneti i qytetarëve i shprehur më 6 tetor.

"Epoka e re": Kosovën e presin shumë sfida. Në mesin e tyre është edhe procesi i dialogut.

Cila do të jetë ecuria e këtyre proceseve në qeverisjen Kurti?

Berisha: Sfiduese për qeverinë e re do të jetë edhe dialogu me Serbinë. Në këtë aspekt duhet një kujdes jashtëzakonisht i madh dhe të mos preken interesat e nacionale. Pra, duhet të ruhet territori dhe

funksionaliteti i shtetit në këto bisedime. Avantazhet e krijuara nga qeveria e kaluar në procesin e dialogut nuk duhet të humbën pasi që qeveria e re duhet t'i shfrytëzojë ato avantazhe në mënyrë që t'i avancojë proceset dhe të jetë sa më e suksesshme përballë Serbisë.

"Epoka e re": Duke qenë në opozitë, do ta mbështetë Aleanca këtë dialog?

Berisha: Aktualisht nuk ka qëndrim. Priten rezultatet e krijimit të qeverisë dhe hapat e caktuar, pastaj organet e partisë do të takohen dhe do t'i diskutojnë veprimet e mëtejshme.

Kurti takohet me Rashiqin, bisedojnë për procesin zgjedhor të 6 tetorit

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti, të dielën është takuar me përfaqësuesin e koalicionit "Sloboda", Nenad Rashiq. Ata janë takuar në njërin nga hotelet në Prishtinë. Pas takimit Kurti ka thënë se Rashiq ishte i zhgënjyer me procesin zgjedhor në vendbanimet me shumicë serbe.

"Nenad Rashiq nuk e ka asnjë aferë apo skandal si ministër. Ai është një ndër ministrat më të mirë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Bisedova me të për procesin zgjedhor në vendbanimet me shumicë serbe dhe ky ishte shumë i zhgënjyer. Unë isha i interesuar që të marr vesh mbi mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në këto komuna", ka

deklaruar Kurti, duke shtuar se institucionet e vendit e kanë obligim kushtetues që t'i integrojnë komunitetet jo vetëm serbe, por edhe të tjerat. "Do të fillojmë dialog me të gjithë. Për këtë gjë fare nuk kemi dallime me LDK-në. Për mua ishte e vlefshme t'i kuptoj ndikimet e dëmshme që bëhen mbi qytetarët serbë të Kosovës", ka thënë Kurti.



Mendoni se ka mundur të ketë manipulime në këtë drejtim?

Berisha: Gjithmonë pas rezultatit të zgjedhjeve ankohen të pakënaqurit dhe kjo është e natyrshme si për parti, si për individë. Pra, jo vetëm në Aleancë, por edhe në partitë e tjera ka ankesa individuale për numërim të votave. Nuk mund të thotë askush se çdo gjë ka qenë në rregull pasi që është e drejtë e secilit të verifikojë se ku kanë qenë të metat dhe nëse ka argumente atëherë janë mekanizmat e caktuar të ankesave në mënyrë që ato kuti ku ka ankesa të bazuara t'i rinumërojnë dhe të vazhdohet tutje me këtë çështje.

"Epoka e re": Ka qenë i pritshëm ky rezultat bazuar në qeverisjen e fundit gati dyvjeçare?

Berisha: Pritjet e Aleancës nuk kanë qenë për këtë rezultat, mirëpo vlerësimi dhe verdikti i popullit ka qenë i tillë dhe ne do ta respektojmë atë. Vullneti i shumicës së qytetarëve ka përcaktuar që kësaj radhe AAK-ja

Rexhep Selimi: I gjithë procesi i dialogut me Serbinë ka qenë gabim

PRISHTINË, 13 TETOR - Zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit Lëvizjen Vetëvendosjen e kanë nxjerrë fituese. Ende pa u formuar legjislatura e shtatë, kreu i kësaj partie, Albin Kurti, ka premtuar reforma të thella në drejtësi, ekonomi, arsim dhe shëndetësi. Por një nga çështjet me prioritet të kësaj qeverie do të mbetet vazhdimi i dialogut Kosovë - Serbi.

Bashkëpartiake i Kurtit, Rexhep Selimi, konsideron se qeveria e udhëhequr nga Kurti do të ketë qasje dhe raport tjetër ndaj dialogut, duke u shprehur se LV-ja nuk do ta lëndojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës. "Ne do të kemi raport dhe qasje krejt tjetër kundrejt Serbisë pa e lënduar asnjëherë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës dhe, po ashtu, me një transparencë maksimale do t'i qasemi këtij problemi që kërkon zgjidhje", ka thënë

Selimi për "EkonomiaOnline".

Ai ka thënë se tashmë Lëvizja Vetëvendosje dhe kryeministri i ardhshëm Albin Kurti ka dhënë qëndrimet dhe deklaratimet e tij se si do t'i qasen raportit me Serbinë. "Raporti me Serbinë nuk do të thotë se do të ketë patjetër negociata. Raporti me Serbinë fillimisht duhet të ketë raport reciprociteti politik, tregtar dhe ekonomik e pastaj përtej kësaj shohim e bëjmë", tha Selimi. Ai është shprehur se procesi i dialogut i zhvilluar deri më tani ndërmjet palës kosovare dhe asaj serbe ka qenë plotësisht gabim, duke e parë Kosovën si palë humbëse.

Madje ai është shprehur se presidentët Thaçi e Vuçiq ishin pajtuar për një sërë marrëveshesh të fshehta. "Ne nuk e shohim asnjë marrëveshje veç e veç dhe nuk i ndajmë këto marrëveshje nga i gjithë procesi. I gjithë procesi ka qenë gabim. Në gjithë atë proces



Kosova veçse ka humbur sepse në atë proces janë diskutuar kërkesat e Serbisë kundrejt Kosovës që kanë qenë kërkesa

kundër Kushtetutës, kundër rendit kushtetues, kundër ndërtimit të brendshëm shtetëror të Kosovës, prandaj ne nuk i nda-

jmë marrëveshjet. Ne e denoncojmë të gjithë procesin si një proces i gabueshëm për Kosovën", ka thënë Selimi.

Projekti i sistemit të tatimit në pronë sjell në Kosovë zyrtarët nga Shqipëria



PRIZREN, 13 TETOR (ER) - Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Artan Abrashi, ka pritur në takim zyrtarët e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, të cilët këto ditë po qëndrojnë në Kosovë për vizitë studimore në kuadër të projektit për vazhdimin e përmirësimit të sistemit të tatimit në pronë në Kosovë. Me këtë rast, kryesuesi Abrashi, duke u uruar mirëseardhje mysafirëve, i njoftoi ata për sfidat dhe sukseset e Komunës në Sektorin e Tatimit në Pronë, si dhe i informoi për ecurinë e procesit të hartimit të rregullores për taksat dhe tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale, duke veçuar komunikimin sidomos me komunitetin biznesor gjatë periudhës së hartimit të

kësaj rregulloreje dhe lirim nga taksat komunale të veprimtarive që merren me zejtari.

Në këtë takim ishin të pranishëm edhe zyrtarët nga Drejtoria e Financave e Komunës së Prizrenit, të cilët dhanë informacione më të hollësishme lidhur me pyetjet e parashtruara, derisa pas takimit së bashku me delegacionin nga Shqipëria u vizituan edhe ambientet e punës të Sektorit të Tatimit në Pronë të Komunës së Prizrenit.

Projekti për vazhdimin e përmirësimit të sistemit të tatimit në pronë në Kosovë po realizohet nga ana e Ministrisë së Financave, me implementim të Agjencisë Suedeze të Tatimeve dhe në bashkëpunim me Departamentin e Tatimit në Pronë dhe Agjencisë Suedeze Kadastrale.

Lulzim Dragidella bëhet pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Lulzim Dragidella është bërë pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje. Lajmin e ka bërë me dije lideri i kësaj parti, Albin Kurti, i cili, nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se Dragidella ka studiuar fillimisht në drejtimin e pedagogjisë dhe punës sociale dhe tani mban titullin doktor shkence në tri fusha: për shkencat arsimore në Universitetin Alanus, Bonn, si

doktor i shkencave arsimore; për të drejtat e njeriut në Universitetin Wraclawski, Breslau, si doktor i shkencave sociale; dhe për sociologji në Universitetin e Komenskit në Pressburg, Bratislavë, si doktor i filozofisë. "Lulzimi ka përfunduar edhe specializime për këto fusha në Wismar, Heidenheim dhe disa vende të tjera të Gjermanisë ku edhe ka zhvilluar një përvojë akademike si në

kërkime e publikime shkencore, po ashtu edhe në mësimdhënie në nivelin universitar. Prof. dr. Lulzim Dragidella sjell dije dhe përvojë të jashtëzakonshme në Lëvizjen tonë që për synim ka t'i kthejë në Kosovë profesionistët e rinj për të kontribuar në sferat me rëndësi jetike për zhvillimin e vendit. Mundësia është për ta dhe me ata, për të gjitha ndryshimet që i duam e na duhen", ka shkruar Kurti.



Pasoja e largimit të Kosovës nga Asociacioni Evropian për Cilësi në Arsim



PRISHTINË, 13 TETOR - Pavarësisht se Kosovës nuk i është vazhduar anëtarësimi në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), njohja e diplomave universitare të cilat lëshohen nga autoritetet kompetente arsimore në Kosovë do të vazhdojnë të njihen edhe jashtë vendit. Kështu bëjnë të ditur për Radion Evropa e Lirë përfaqësues të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë për Akreditim të Kosovës.

Gazmend Luboteni, kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" hedh poshtë raportimet, siç thotë ai, nëpër disa media, ku ishte thënë se diplomat universitare nuk do të njihen tash e tutje. "Unë mendoj se çështja më e rëndësishme që duhet të dijë publiku është për mobilitetin e studentëve. Do të thotë, nuk mund të themi se diplomat nuk mund të njihen, pasi që Kosova ka qenë anëtare (në ENQA) nga 2014 deri në 2019, ngase edhe më parë deri në vitin 2014 Kosova nuk ka qenë anëtare, por diplomat e saj janë njohur edhe jashtë vendit në Evropë dhe më gjerë", ka theksuar ai, duke shtuar se mos të kuptohet në opinion, që të gjitha diplomat

që vlejnë këtu në Kosovë dhe lëshohen këtu nuk vlejnë jashtë vendit. "Kosova ka qenë edhe në periudhën e luftës '99 e tutje dhe ato diploma që janë marrë në gjendje të jashtëzakonshme janë njohur në vendet e tjera jashtë Kosovës", ka sqaruar Luboteni.

Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë është organizatë që përfaqëson anëtarët e saj në Evropë dhe më gjerë. Ky mekanizëm javë më parë kishte marrë vendim që të mos vazhdonte anëtarësimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës në këtë mekanizëm për shkak të, siç thuhet, mosplotësimit të kriterëve evropiane të kërkuara, në veçanti ishte theksuar ndërhyrja politike në Agjencinë për Akreditim të Kosovës.

ENQA si ndërhyrje politike e ka konsideruar vendimin e ministrit në largim të Arsimin, Shyqiri Bytyqi, të marrë me kërkesën e kryeministrit në largim, Ramush Haradinaj, për ta shkarkuar Këshillin Shtetëror të Cilësisë në vitin 2017.

Përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë si dhe mekanizmat ndërkombëtarë patën reaguar në lidhje me mosvazhdimin e anëtarësimin të Agjencisë për Akreditim të Kosovës në ENQA. Shefja e Zyrës së Bashkimit

Kosova do të riaplikojë në ENQA

Në njoftim-vendimin e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dërguar Agjencisë së Kosovës për Akreditim bëhet me dije se kjo Agjenci mund të aplikojë sërish për anëtarësim dy vjet pas marrjes së këtij vendimi. Lidhur me rianëtarësimin në këtë mekanizëm, Luboteni thotë se do të vazhdojnë procedurat për riaplikim. "Të gjitha vërejtjet do të merren

parasysh dhe se do të bëjmë aplikim të sërishëm në ENQA. Ne tani do të vazhdojmë me të gjitha kriteret për shkak se standardet evropiane të cilësisë ne jemi duke i aplikuar dhe do të vazhdojmë t'i aplikojmë, pavarësisht që nuk jemi anëtar tani të ENQA-s. Ne do t'i vazhdojmë përsëri procedurat për aplikim. Ligji për Agjencinë për Akreditim, që është kërkesa kryesore e ENQA-s,

është në draft dhe është gati final, si i tillë duhet të miratohet në Kuvend dhe të gjitha këto duhet të tejkalohen", ka theksuar Luboteni.

Spektori i arsimit në Kosovë për vite me radhë është përballur me probleme të mëdha dhe pa përmirësim të duhur në fusha të caktuara. Cilësia e dobët në arsim është theksuar si një nga problemet më të mëdha që përballen ky sektor në Kosovë.

Evropian në Prishtinë, Nataliya Apostolova, përmes një deklaratë për media pati fajësuar qeverinë dhe politikën për këtë situatë. Ndërkaq organizatat joqeveritare në Kosovë që merren me arsimin kishin fajësuar politikën, por edhe keqmenaxhimin e vet Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Veç të tjerash, shoqëria civile e kishte konsideruar përjashtimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga ENQA si dëm të

madh për studentët që regjistrohen në programet e akredituara pas vitit 2019, posaçërisht në çështjen e njohjes më të lehtë të diplomave të tyre jashtë Kosovës.

Sa iu përket vështirësive që do t'i kenë studentët tani pas mosvazhdimin të anëtarësimin të Kosovës në ENQA, Gazmend Luboteni thotë se mund të ketë vështirësi në mobilitetin e studentëve. Sipas tij, një student i një shteti që është anëtar në

ENQA ka të drejtë ta shfrytëzojë logon që parashihet me marrëveshjen me ENQA dhe ata do ta kenë më të lehtë vazhdimin e studimeve master apo doktoraturën në një universitet evropian. Derisa studentët nga Kosova, shton Luboteni, të cilët do dëshirojnë të vazhdojnë studimet master apo doktoraturën jashtë Kosovës, mund të janë në disavantazh me studentët e vendeve anëtare të ENQA.

Ministria e Bujqësisë krijon departament të veçantë për vreshtarët dhe verëtarët



PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Tani e tutje verëtarët e Rahovecit nuk kanë nevojë të presin gjatë për t'i kryer shërbimet administrative. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka ngritur një departament të veçantë në këtë qytezë, i cili merret ekskluzivisht me çështje që ndërlidhen me vreshtarinë dhe vertarinë.

Drejtori i Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë, Bekim Hoxha, thotë se në këtë mënyrë janë më afër fermerëve. "Jorastësisht lokacioni gjendet në Rahovec dhe jemi shumë afër prodhuesve, përpunuesve, vertarëve dhe vreshtarëve të cilët kanë nevojë për një shërbim të shpejtë dhe efikas. Departamenti i Vreshtarisë dhe Vertarisë është i strukturuar në bazë të mandatit që e ka, në katër divizione. Divizioni i vreshtarisë, divizioni i vertarisë, divizioni për paralajmërimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të hershëm dhe divizioni i laboratorit", ka thënë Bekim Hoxha, drej-

tori i këtij departamenti.

Divizionin e Vreshtarisë në këtë departament e udhëheq Nesim Morina.

Ky divizion menaxhon të gjitha vreshtat në Kosovë. "Divizioni i vreshtarisë merret me menaxhimin e të gjitha vreshtave në Kosovë, njëkohësisht bën menaxhimin e kadastrës së vreshtave. Evidenton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet në regjistrat e vreshtave. Në kuadër të divizionit ofrojmë një varg shërbimesh për fermerët vreshtarë. Lëshojmë më shumë se 4 000 certifikata për çështje të ndryshme që u duhen vreshtarëve, duke filluar nga grandet, subvencionet, për çështjen e hipotekave dhe për nevojat që i kanë vreshtarët", ka bërë me dije Morina.

Ndërsa Divizioni i Verëtarisë në këtë departament udhëhiqet nga Ylber Kuçi. Një prej punëve kryesore të këtij divizioni është që në treg të plasohen vetëm verërat cilësore. "Një shtyllë e veçantë e

sistemit tonë ka të bëjë me administrimin e sistemit ku ne këtu i integrojmë të gjitha ndryshimet e fundit që ndodhin dhe që miratohen nga Bashkimi Evropian sepse praktikat tona dhe vetë tregu i verës është i orientuar nga Bashkimi Evropian, prandaj jemi detyruar t'i kemi këto përmirësime dhe ta bëjmë përditësimin e tyre", ka thënë Kuçi. Departamenti përkujdeset edhe për vreshtat e fermerëve, që ato mos të dëmtohen qoftë nga ndonjë sëmundje, qoftë nga ndonjë gjë tjetër. Ata kanë instaluar një sistem, i cili u jep informacione të shpejta e të sakta për gjendjen në vreshta. "Ne nëpërmjet këtij sistemi japim informata të shpejta dhe të sakta për mikroklimën në vreshta, sepse i kemi pajisjet e montuara në vreshta, pastaj na jep informata për kohën se kur paraqitet dëmtuesi ose sëmundja në vreshta. Kohën dhe intensitetin e saj. Në bazë të këtyre, ky sistem na jep mundësi që ta bëjmë përgatitjen se çfarë masa duhet të ndërmerret fermeri, preventive apo kurative", ka deklaruar Sylejman Bala, punonjës i Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë. Ky sistem, sipas Balajt, mund ta ulë koston e prodhimit diku për 20 për qind. Pjesë e departamentit është edhe laboratorit, ku me shumë kujdes kontrollohet standardi i verërave. Ky laborator i testimit të verës është i akredituar në bazë të standardit 17 025 që nga viti 2014. Përndryshe në laborator bëhet testimi i verërave si për eksport, ashtu edhe për import. "Në laborator vijnë mostrat, shifrohen dhe në laborator më pas testohet vera. Në bazë të parametrave fiziko-kimikë të verës, lëshohet certifikata për eksport ose import të verës", ka bërë me dije Selami Vuçitërrna, menaxher i laboratorit.

Departamenti ka ndërtuar edhe një serrë, në të cilën ruhen klone të ndryshme të rrushit. Nga këto

klone më pas u jepen sugjerime fermerëve se çfarë lloje të rrushit të mbillen. Ky departament është duke e ndërtuar një bodrum, në të cilin do të testohen këto klone. "Do të jetë bodrumi për testimin e kloneve, të cilat do të prodhohen, do të testohen dhe pas këtij testimi do të jepen rekomandime për klone të caktuara me parametrat të cilat janë paraparë në varietetet të cilat do t'i kultivojmë dhe që realisht janë në kultivim e sipër. Ky laborator i enologjisë, gjegjësisht i mikroverifikimit, do të shërbejë për eksperimente të ndryshme, do të jetë në shërbim të fermerëve, përpunuesve, mbi të gjitha do të jetë në shërbim të sektorit të verëtarisë ku do të testohen të gjitha çështjet sa i përket enologjisë", ka thënë Bekim Hoxha, drejtor i Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë.

E nga ky bodrum do të dalin edhe verërat më cilësore që drejtuesit e institucioneve kosovare do t'i shpërndajnë ato si dhurata.





Kosnetti takon fermerët: Fuqia më e madhe e Kosovës është populli

MITROVICË, 13 TETOR (ER) - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë (ShBA), Philip Kosnett, ka takuar fermerët lokalë të cilët përdorin teknologjinë e gjelbër në veri të Kosovës. Kjo është bërë me dije nga Ambasada e Amerikës në Prishtinë përmes në postimi në rrjetin social "Facebook". Ambasadori

Kosnett ka thënë se fuqia më e madhe e Kosovës është populli i saj. "Shndërrimi i bimëve të egra në vajra esenciale është një proces i ngadaltë dhe i ndërlikuar. Kështu është edhe ndërtimi i demokracisë gjithëpërfshirëse në një vend si Kosova. Por suksesi do të sjellë përfitime për brezat që vijnë", ka thënë Kosnett.



Fermerët shqiptarë në vështirësi, nuk shiten prodhimet

Tiranë, 13 tetor - Në shumë zona në Shqipëri fermerët po vihen në vështirësi për shkak se prodhimi nuk gjen treg si brenda dhe jashtë vendit. Disa qindra fermerë në zonën e Fierit, Beratit dhe Lushnjës që merren me prodhimin e

domates kërkojnë mbrojtjen e prodhimit vendës. Sipas tyre, dhjetëra tonë domate nuk arrijnë të shiten, ndërkohë që sipërmarrjet bujqësore rrezikojnë falimentimin pasi investimet janë realizuar përmes kredive bankare.

Banka Botërore nuk parasheh rritje ekonomike që ul papunësinë

PRISHTINË, 11 TETOR - Kosova ka vite që shënon rritje ekonomike, por shkalla e rritjes ende mbetet e pamjaftueshme për ta zbutur papunësinë dhe rimëkëmbur ekonominë. Perspektiva e rritjes ekonomike në Kosovë parashihet të jetë pozitive, me rritje mesatare prej 4.2 përqindësh. Krahasuar me vendet e rajonit, të cilat, sipas Bankës Botërore, po përjetojnë ngadalësim, Kosova ka rritje më të lartë.

Bazuar në raportin e fundit të titulluar "Rregullat ekonomike për Ballkanin Perëndimor", ku përfshihet edhe Republika e Kosovës, thuhet se niveli i rritjes ekonomike gjatë këtij viti është 4 për qind.

Parashikimet e Bankës Botërore për rritjen ekonomike për vitin 2020-2021 janë 4.2, respektivisht 4.1 për qind. Por, raporti konstaton "se ekzistojnë rreziqe të padëshirueshme që lidhen me dinamikën e politikës së brendshme dhe rajonale, vonesa të mundshme në planet e investimeve për shkak të zgjedhjeve, koston më të lartë sesa është parashikuar të Ligjit të ri për pagat në sektorin publik dhe stabilitetit të çmimeve ndërkombëtare të metaleve".

Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar më herët ka parashikuar se rritja ekonomike për vitet 2020 deri në vitin 2024 do të jetë më shumë se 4 për qind. Ekspertë të çështjeve ekonomike



vlerësojnë se, pavarësisht rritjes ekonomike, kjo normë nuk adreson problemet me të cilat përballet Kosova.

Drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se norma e rritjes ekonomike nuk do të arrijë në 4.5 për qind. "Këto vlerësime janë të bazuara kryesisht në projektet që janë të ndikuara nga investimet publike dhe në të njëjtën kohë ndërlidhen edhe me rritjen e kon-

sumit që lidhen me remitencat apo nga faktorë të tjerë të caktuar, siç është rritja e pagave që mund të ketë ndikim afatshkurtër, por jo ndikim afatgjatë", ka thënë Rukiqi.

Pasiviteti në tregun e punës në rajon ka pësuar rritje gjatë vitit 2019, thuhet në raport, kurse në Kosovë dhe në Bosnje e Hercegovinë, sipas raportit, numri i njerëzve që kanë lënë punën është më i lartë se i atyre që kanë gjetur punë.

Shkalla e papunësisë në Kosovë, sipas të dhënave zyrtare, është 25.3 për qind.

Edhe eksperti tjetër për çështje ekonomike, Ismail Kastrati, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" thotë se norma e parashikuar e rritjes ekonomike nuk është e mjaftueshme për zvogëlimin e shkallës së papunësisë në Kosovë. "Për t'u ulur shkalla e papunësisë, rritja ekonomike duhet të jetë mbi 7 për qind. Ndërsa 21 për qind e investimeve duhet të jenë të ndara

nga Bruto Produkti Vendor", thekson Kastrati.

Ndërkaq Berat Rukiqi konsideron se parashikimet e institucioneve financiare ndërkombëtare për rritje ekonomike nuk arrijnë ta ulin shkallën e papunësisë në vend. "Kosova, edhe pse ka një ulje të papunësisë edhe te të rinjtë, mbetet një ndër vendet me normat më të larta në rajon. Kështu që, me këtë nivel të rritjes ekonomike dhe duke pasur parasysh numrin e madh të të rinjve që dalin në treg të punës për çdo vit është e pamundshme që të adresohet me këtë rritje zgjidhja e këtij problemi që është problem kryesor ekonomik në vend", ka vlerësuar Rukiqi.

Raporti i Bankës Botërore, gjithashtu, bën thirrje për një përmirësim të shpejtë të shpenzimeve publike dhe konkurrueshmërisë së ekonomive. Aty kërkohet edhe forcimi i kontrollit të shpenzimeve publike për paga, reduktimi i shpenzimeve tatimore dhe përmirësimi i programeve të përkrahjes sociale.

Nga parashikimet e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, subjektet politike që garuan në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit kanë premtuar rritje të normës vjetore ekonomike në Republikën e Kosovës, nga 6 deri 9 për qind, për katër vjetet e ardhshme.

Nesër në kryeqytet fillon procesi i eliminimit të brejtësve

PRISHTINË, 13 TETOR (ER) - Nesër (e martë) fillon procesi i deratizimit vjeshtor (eliminimit të brejtësve) i rrjetit të kanalizimit, bodrumeve dhe garazheve publike nëpër lagjet e Prishtinës. Sipas njoftimit të Komunës së Prishtinës, ky proces ka për qëllim ruajtjen e shëndetit publik përmes zvogëlimit dhe

mbajtjes nën kontroll të numrit të brejtësve që qarkullojnë nëpër rrjetin e kanalizimit e që mund të paraqesin kërcënim për shëndetin publik të qytetarëve. "Bashkëpunimi i qytetarëve në këtë aktivitet është shumë i rëndësishëm. Prandaj, lusim qytetarët të na përkrahin në mënyrë që ky

aktivitet të realizohet me sukses. Kërkohej nga qytetarët që t'i hapin dyert e bodrumeve dhe garazheve në mënyrë që të sigurohet qasje e lehtë në këto hapësira, derisa monitorimi i këtij procesi do të jetë i vazhdueshëm", është theksuar në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



Arrestohen katër persona të dyshuar për bixhoz të paligjshëm në Gjakovë



GJAKOVË, 13 TETOR (ER) - Policia e Kosovës ka bërë me dije se ka arrestuar në Gjakovë katër persona të dyshuar për veprën penale organizim të skemave piramidale dhe bixhoz të paligjshëm. "Janë arrestuar katër të dyshuar meshkuj k/shqiptarë të cilët nga një siti policor janë hasur duke luajtur lojëra fati në një lokal pa emër, pronari i të cilit lokal nuk kishte qenë aty dhe nuk është identifikuar. Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë relevante policore ku kanë konfiskuar tre monitorë, një serv-

er të kamerave, një 'dream-box', një roter dhe 170 euro para të gatshme që kishin qenë në aparate të lojërave", ka njoftuar policia. Sipas këtij njoftimi, përveç një sive policore, në atë lokacion kanë dalë edhe zyrtarët e Doganës së Kosovës të cilët e kanë bërë konfiskimin e tre aparateve të lojërave të fatit si dhe inspektorët komunalë të cilët e kanë mbyllur lokalin. Të dyshuarit, pas intervistimit, me urdhër të prokurorit, janë liruar në procedurë të rregullt gjyqësore.

Kaçaniku i Vjetër shënon ditën e shkollës dhe ditëlindjen e komandant Bardhit

KAÇANIK, 13 TETOR (ER) - Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër ka shënuar ditën e shkollës dhe ditëlindjen e komandant Bardhit. Fillimisht për historikun e shkollës ka folur drejtori i shkollës "Qamil Ilazi", Bislim Krasniqi, i cili ka thënë se historinë kombëtare e karakterizuan vuajtjet e shumta si dhe përpjekjet për hapjen e shkollave shqipe. "Në Kaçanik të Vjetër në vitin 1930 u hap shkolla, por vetëm në gjuhën serbe, kurse në vitin 1945 po në këtë shkollë u mësua edhe në gjuhën shqipe", ka thënë Krasniqi derisa ka uruar nxënësit dhe arsimtarët për ditën e shkollës si dhe për ditëlindjen e 71-të të komandant Bardhit.

Nxënësit dhe mësuesit i ka uruar edhe nënkryetari i Komunës së Kaçanikut, Ylber Bajra, i cili ka thënë se komandant Bardhi ishte një



vigan që nga fëmijëria ia kushtoi jetën dhe veprimtarinë e tij të mirës së atdheut. Bajra ka porositur nxënësit që të mësojnë dhe të punojnë për vendin e tyre. Edhe drejtori i Arsimit dhe Kulturës, Zahir Doda, ka uruar nxënësit dhe mësuesit për ditën e shkollës, ndërsa ka thënë se dita e shkollës ka veçantinë e vet, sepse është një ditë mobilizimi, promovimi e vlerësimi, mbi të gjitha një ditë gëzimi për nxënësit. Ai ka uruar që vitin e ardhshëm këtë ditë ta festojmë në kushte evropiane në objektin e ri shkollor, i cili është në ndërtim e sipër. Në fund nga nxënësit e shkollës "Qamil Ilazi" është shfaqur një program kulturor artistik. Pas programit festiv janë bërë homazhe dhe janë vendosur kurora me lule pranë bustit të komandant Bardhit, në oborrin e shkollës si dhe te varrezat e dëshmorëve.

Rregullohen varrezat e veteranëve të UÇK-së në Kaçanik

KAÇANIK, 13 TETOR (ER) - Komuna e Kaçanikut ka njoftuar se ka rregulluar varrezat e veteranëve të UÇK-së në këtë komunë. Sipas

një njoftimi të kësaj komune, projekti për rregullimin e këtyre varrezave është financuar nga buxheti komunal. "Në kuadër të pro-

jektit 'Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve' është duke u bërë rregullimi i varrezave të veteranëve të UÇK-së në kompleksin

memorial. Projekti është duke u financuar nga buxheti komunal", është thënë në njoftimin e Komunës së Kaçanikut.



Për çmimin Nobel dhe gjenocidin



Nga Bedri ISLAMI

Në njërin nga ditët e fundit më rastisi të isha në Würzburg, një qytet i vjetër, ku e shkuara është pleksur me të tashmen. Kam qenë shpesh atje gjatë kohës së luftës në Kosovë.

Në një sallë të zakonshme, ku kishte edhe një aneks dhe mund të gatuhej, janë bërë disa nga mbledhjet e Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së, ku mermin pjesë edhe anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Drejtorisë Politike të UÇK-së.

Por qytetin nuk e kisha vizituar. Kisha qenë deri në qendër, ku rrugët bashkohen e ndahen me njëra tjetrën, mes tyre ecin tramvajet e zhurmshëm, dyqanet e mëdha shfaqnin konfortin e tyre, por brenda nuk kisha qenë asnjëherë.

Aso kohe ne flinim në shtëpitë e shokëve dhe, ndërsa zhvilloheshin

takimet e gjata, të zhurmshme nganjëherë, me përplasje dhe ide që në fund të fundit ishin lirisjellëse, disa nga anëtarët e organizatës, që nuk ishin pjesë e forumeve, gatuanin diçka dhe pushimet ishin të shkurtra.

Kësaj here kisha më shumë kohë dhe në një ditë të premtë, si kjo, ndërsa binte shi dhe dola nga biblioteka e qytetit, vendosur në një godinë të stilit të vjetër, pas disa hapave, krejt në qendër, ishte një librari e madhe, e quajtur "Hugendubel", me konfortin që duan librat, hapësirat, disakatëshe dhe në secilin prej tyre mund të uleshe të lexoje, të pije një kafe dhe të shfletoje median e gjithë botës.

E ndjeva ngrohtësinë e veçantë që të jep prania e librit. E veçantë e dashur, mikuese, ndjellëse dhe, si gjithnjë, e papritur.

U afrova tek njëri ndër shitësit, që nuk janë bakaj librash, dhe e pyeta, nëse në librarinë e tyre kishin ndonjë libër të Ismail Kadaresë.

- Kadare, tha ai, mbajti i çmimit Nobel?

Dhe po hapte kompjuterin e tij, që, pas pak, e ktheu nga unë dhe më tregoi listën e pafund të botimeve Kadare në gjuhën gjermane.

Një listë e pafund vetëm në gjuhën

gjermane.

I thashë se Kadare nuk është mbajti i çmimit Nobel për letërsi, por që disa vite qëndron në listën e të propozuarve.

Nuk i mbushej mendja. Këmbëngulte për të më mbushur mendjen se ai është mbajti i këtij çmimi.

I thashë se, për shkaqe që askush nuk i di, dhe që as ia vlejnjë të dihen, ai nuk e ka këtë çmim, megjithëse lista e çmimeve dhe dafinave dhënë Atij është e

pafund.

Shikonte në kompjuterin e tij, gjeti atë që kërkonte, u rruhd pak dhe më tha:

- Më vjen keq për ata që japin këtë Çmim. Vetëm për ata. Kadare është i gjithë botës.

U largova, përsëri nëpër një shi të imët që dukej sikur nuk do të kishte fund.

Kur dëgjova mbrëmjen e djeshme se kush ishte bartësi i këtij çmimi për vitin 2018, mendja më shkoi tek ai librari, në një qytet mesatar

gjerman, tejet i lidhur me kulturën, si është Würzburgu, tek rrotullisja e ngjarjeve dhe përsëritja e tyre në vite, sidomos tek një shkrimtar tjetër serb, Ivo Andrić, funksionar i lartë i qeverive jugosllave, fitues i këtij çmimi në vitin 1961, i cili hartoi planin brutal dhe gjenocidal për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova dhe vendosjen atje të kolonëve serbë. Çfarë po ndodh me ty Stokholm?

Mëkati i krimtit ku nuk ke qenë kurrë pjesë?



Sfidat që e presin Albin Kurtin dhe Kosovën



Nga Janusz BUGAJSKI

Kosova ka arritur në një udhëkryq të rëndësishëm në zhvillimin e saj si një shtet i pavarur. Dy parti opozitare, në mënyrë të habitshme, fituan zgjedhjet e përgjithshme të 6 tetorit dhe tani iu duhet të ndërmarin "një pastrim madhor të shtëpisë" për t'i reformuar institucionet e vendit. Edhe emërimi i një të dërguari të ri të Shteteve të Bashkuara për t'i rifilluar bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë mund të japë një shtysë të re drejt një zgjidhjeje përfundimtare të një prej problemeve rajonale më të paprekshme. Gjatë fushatës zgjedhore, krimi dhe korrupsioni, së bashku me kujdesin shëndetësor dhe arsimin, ishin në krye të agjendës. Qeveria e ardhshme duhet të angazhohet që të çrrënjosë abuzimet më të këqija jo vetëm verbalisht; ajo duhet që, më në fund, të fillojë të përmbushë

(premtimet). Sloganet që thjesht përsëriten mund të mos e qetësojnë më një elektorat që është irrituar në vazhdimësi nga mungesa e përparimit ekonomik ose mund të mos kënaqë lojtarët ndërkombëtarë që e shohin vendin si të "mbërthyer në një kurth".

Nisma antikorrupsion duhet të fillojë brenda institucioneve qeveritare. Standarde të repta llogaridhënieje dhe raportimi i të gjitha pasurive në pronësi të zyrtarëve duhet të jenë të detyrueshme, ndërsa çdo kontakt mes zyrtarëve të zgjedhur dhe përfaqësuesve të biznesit duhet të jetë transparent dhe i hapur për hetim. Reforma gjyqësore, gjithashtu, duhet të përfundohet, duke zëvendësuar gjyqtarët dhe prokurorët që u bënë të pasur me rryshfete.

Zyrtarët serbë pretendojnë se Kosova është një shtet i dështuar, i mbushur me kriminalitet, i cili nuk meriton njohjen ndërkombëtare. Masat për të luftuar korrupsionin do t'i jepnin mesazhin e qartë institucioneve ndërkombëtare, që Kosova është serioze për t'u kualifikuar për anëtarësim. Kreu i Vetëvendosjes, Albin Kurti, mund të jetë figura më e rëndësishme, që nga pavarësia, që do t'i bëjë ballë korrupsionit shtetëror.

Një detyrë e tjetër e rëndësishme e qeverisë së re është të flasë me një zë (unanimisht) në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së saj me Serbinë. Sa më shpejt që qeveria e koalicionit midis Vetëvendosjes dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) të formohet atëherë mirë (është) për vendin, përndryshe do të krijohet perceptimi i pasigurisë dhe mungesës së unitetit. Administrata e re duhet të ketë një qëllim të qartë: njohjen e plotë ndërkombëtare dhe përfshirjen në të gjitha organizatat kryesore ndërkombëtare. Çfarëdo (tjetër) që është më pak se kaq nuk do të sjellë stabilitet në rajon.

Emërimi i ambasadorit të ShBA në Gjermani, Richard Grenell, si i dërguari për dialogun Kosovë-Serbi, tregon se Shtëpia e Bardhë është e vendosur të normalizojë marrëdhëniet, pasi, tashmë, kishte emëruar Matt Palmer, zëvendës ndihmës Sekretarin e Shtetit, si të dërguar të posaçëm për Ballkanin Perëndimor. Ndonëse Grenell është "fillestar" në rajon, Palmer është një zyrtar "i regjur" i Departamentit të Shtetit i cili është i ndërgjegjshëm për kompleksitetet e Ballkanit.

Mosmarrëveshja mbi normalizimin mund të zgjidhet plotësisht vetëm nëse Serbia pranon

pavarësinë e Kosovës. Grenellit do t'i bëhet shumë presion për të gjetur shpejt formulën për të arritur diçka të tillë. Atij do t'i duhet të punojë me përfaqësuesit e BE-së, por, si ambasadori amerikan në Berlin, ai ka qenë shumë kritikues ndaj politikës së jashtme gjermane. Grenell me sa duket u rekrutua pikërisht për shkak të përvojës së tij si negociator në Kombet e Bashkuara. Prishtinës i duhet të bashkëpunojë ngushtë me të dy të dërguarit, duke shfaqur gatishmëri për kompromis për çështje të caktuara, si për shembull heqja e taksave (100%) ndaj Serbisë. Nga ana tjetër, asaj i duhet të shmangë çdo 'kurth' të vendosur nga Beogradi gjatë bisedimeve të ardhshme.

Disa vëzhgues kanë spekuluar se Grenell do të jetë më i hapur për shkëmbime territoriale për (të siguruar) njohjen nga Serbia. Sidoqoftë, ai do të përballet me pengesa të rëndësishme politike, pasi udhëheqësit e qeverisë së re në Prishtinë mund të humbin shumë nga mbështetja e tyre publike, nëse vihet re se (ata) po i dorëzojnë toka Beogradit.

Po kështu, qeveria serbe nuk ka të ngjarë të shkëmbejë ndonjë (pjesë) territori për katër komunat veriore në Kosovë, ashtu si shumë

vëzhgues kanë spekuluar, sidomos teksa zgjedhjet parlamentare në prill të vitit 2020 po afrohen. Presidenti serb Aleksandar Vučić është shprehur i çuditur me vendimin e Uashingtonit për të emëruar dy të dërguar specialë për të përshpejtuar procesin e negociatave. Beogradi gjithmonë i ka drejtuar sytë nga Brukseli për të manipuluar dhe vonuar çfarëdo marrëveshje me Kosovën, duke shpresuar se mund të nxisë kryeqytete të ndryshme kundër njëritjetrit dhe të hyjë në BE para se të arrijë ndonjë marrëveshje përfundimtare me Prishtinën.

Duke pasur parasysh urgjencën e rritheksuar të Uashingtonit për zgjidhje, Beogradi mund t'i drejtohet gjithnjë e më shumë Moskës, për të neutralizuar ose prishur nisimën, nëse (nisma) synon të 'kurorëzohet' me njohjen e Kosovës dhe anëtarësimin e saj në Kombet e Bashkuara. Rusia madje mund të emërojë të dërguarin e saj ose të kërkojë një pozitë të barazvlefshme në këtë proces. Por ia vlen të kujtojmë se marrëveshjet e vetme që janë zbatuar me të vërtetë në rajon, siç janë Dayton dhe Prespa, janë ato ku Moska nuk ka luajtur asnjë rol.

(Marrë në gazetën Dita në Shqipëri)

Merkel i kërkon Erdoganit që ta ndalë" ofensivën në Siri

BERLIN, 13 TETOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel ka kërkuar "ndërprerjen e menjëhershme të operacionit ushtarak" të Turqisë në Siri. Këto komente ajo i bëri gjatë një bisede telefonike me presidentin turk, Rexhep Tajip Erdogan, tha një zëdhënese e Qeverisë gjermane. Pavarësisht prej interesave legjitime të sigurisë që ka Turqia, ky

operacion po kërcënon zhvendosjen në masë të madhe të popullsisë lokale, po destabilizon rajonin dhe po rrezikon ringjalljen e grupit militant Shteti Islamik, tha zëdhënësja e Qeverisë gjermane. Turqia ka nisur para pesë ditësh operacionin ushtarak në veri të Sirisë, duke thënë se ka për cak milicite kurde dhe ata të IS-it, por aleatët perëndimorë e kanë kri-

tikuar këtë veprim të Ankarasë. Ankaraja i konsideron milicite kurde terroristë dhe thotë se kanë lidhje me Partinë e Punëtore të Kurdistanit, të cilët për dekada bëjnë kryengritje brenda territorit të Turqisë. Sipas Kombeve të Bashkuara, rreth 130 mijë persona janë zhvendosur pas përshkallëzimit të dhunës në verilindje të Sirisë



Presidenti Trump sfidon hetimet

Presidenti Trump është hedhur në betejë për t'iu kundërvënë hetimeve të udhëhequra nga demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve, të cilat mund të çojnë në hapjen e procesit për shkarkimin e tij

WASHINGTON, 13 TETOR - Presidenti Donald Trump dhe demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve janë mbërthyer në një betejë kushtetuese lidhur me procesin për shkarkimin e mundshëm të presidentit. Shtëpia e Bardhë ka bllokuar zyrtarë të ekzekutivit të dëshmojnë dhe nuk ka ofruar dokumentet e kërkuara nga demokratët për hetimet që mund të çojnë në hapjen e procesit për shkarkimin e presidentit. Në qendër të hetimeve janë bisedat dhe kërkesat e presidentit ndaj homologut ukrainas. Përplasja mes ekzekutivit dhe legjislativit ka zgjuar pyetje mbi pushtetin e presidentit, balancën e autoriteteve mes degëve të ndryshme të qeverisjes dhe statusin e demokracisë amerikane, ka njoftuar voa.

Presidenti Trump është hedhur në betejë, për t'iu kundërvënë hetimeve të udhëhequra nga demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve, të cilat mund të çojnë në hapjen e procesit për shkarkimin e tij. "Njerëzit e kuptojnë se është mashtrim. Po përpiqen t'i fitojnë zgjedhjet e 2020

duke përdorur këtë proces. Fituar në atë mashtrimin tjetër me hetimet e Muellerit. U bë gjithë ajo zhurmë për dy vjet e gjysmë. Për pak ditë ramë në qetësi por krejt papritur filluan këtë tjetër", tha presidenti. Ky ballafaqim u ashpërsua ditët e fundit kur Shtëpia e Bardhë i dërgoi Kongresit një letër, ku e cilëson procesin hetimor si një gjueti shtrigash me qëllime partiake dhe deklaroi se nuk do të bashkëpunojë.

Demokratë, si ligjvënësi Adam Schiff, janë të vendosur të vazhdojnë hetimet. "Nëse nuk lejojnë dëshmitarin të vijë t'u përgjigjet pyetjeve dhe nuk dorëzojnë dokumentet, do ta konsiderojmë si një tjetër provë e fortë se po pengohen funksionet që Kushtetuta i jep Kongresit si degë e barasvlershme e pushtetit", tha Schiff.

Përkrahësit e Trumpit, si ligjvënësi republikan Matt Gaetz, janë gati të hidhen në betejë për të mbrojtur presidentin. "Ky proces është farsë. Kryetari i Komisionit të Shërbimeve të Zbulimit Adam Schiff po vepron



si drejtues keqdashës në këtë farsë", tha Gaetz.

Në bazë të Kushtetutës, Kongresi ka autoritetin t'i kërkojë llogari presidentit përmes procesit që mund të çojë në shkarkimin e tij, thotë eksperti ligjor Paul Schiff Berman. "Çdo abuzim autoriteti, apo abuzim me pushtetin që i jep posti mund të konsiderohet si shkelje që çon në këtë proces. Kushtetuta nuk flet specifikisht për këtë temë, prandaj varet si interpretohet dhe çfarë dinamikash politike hyjnë në lojë", tha ai.

Vendimi i presidentit për të mos bashkëpunuar me Kongresin të kujton qëndrimin që mbajti pres-

identi Nixon gjatë skandalit Watergate në 1974.

Gjykata e Lartë ndërhyri duke e detyruar presidentin Nixon të dorëzonte regjistrime që e implikonin atë në akte të paligjshme, gjë që çoi në dorëheqjen e presidentit, thotë historiania Barbara Ann Perry. "Presidentët gjithmonë bëjnë rezistencë. Gjykata ose Kongresi përgjigjen me presion me autoritetin që kanë dhe zakonisht presidenti humbet", tha ajo. Por, rezultati i procesit hetimor mbetet i paparashikueshëm dhe ndoshta fjala e fundit do t'u takojë votuesve, të cilët do të japin vendimin përfundimtar në nën-

tor 2020 në zgjedhjet presidenciale, thotë analisti Berman. "Gjykatat mund t'i kërkojnë llogari presidentit për çështje politike në përgjithësi. Por për një temë si kjo që kemi tani, kur kemi të bëjmë me shkelje personale, Kushtetuta ka lënë si zgjidhje ose procesin për shkarkimin e mundshëm të presidentit, ose vendimin e amerikanëve në ditën e votimeve", tha ai. Ndërkohë që mbetet pak më shumë se një vit deri në ditën e votimeve, amerikanët dhe Kongresi përgatiten për procesin e katërt për shkarkimin e mundshëm të një presidenti në historinë e ShBA-së.

John Sullivan, ambasador i ri amerikan në Rusi



WASHINGTON, 13 TETOR - Presidenti Donald Trump ka emëruar John Sullivan si ambasadorin e ri amerikan në Rusi.

Sullivan aktualisht është zyrtari numër 2 në Departamentin e Shtetit dhe, nëse konfirmohet

në postin e ri nga Senati, ai do të zëvendësonte Jon Huntsman Jr., i cili njoftoi në gusht se po hiqte dorë nga pozita e tij si diplomat i lartë amerikan në Rusi.

Presidenti Trump e njoftoi vendimin për emërimin e

Sullivanit të premtën pasi tha se po e konsideronte atë për postin.

John Sullivan ka qenë zëvendës sekretar amerikan i Shtetit që herët në administratën Trump, dhe shërbeu për pak kohë vitin e kaluar si ushtrues detyre i

Sekretarit të Shtetit kur presidenti Trump shkarkoi Rex Tillerson. Ai u konfirmua nga Senati në vitin 2017 me një votim 94-6, duke marrë një mbështetje të gjerë si nga republikanët, ashtu edhe nga demokratët.

Polonia ka mbajtur zgjedhjet parlamentare

VARSHAVË, 13 TETOR - Polonia ka mbajtur të dielën zgjedhjet parlamentare për 460 anëtarë në Dhomën e Ulët të parlamentit dhe 100 në Senat për një mandat katërvjeçar.

Mbështetësit e Partisë konservatore në pushtet Ligji dhe Drejtësia, e cila është në avantazh, e shikojnë votimin si një shans për të ruajtur përfitimet e

mira sociale mujore që kanë rritur standardet e jetesës.

Përkrahësit e partisë në pushtet e miratojnë qasjen konservatore në vend, në një kohë të ndikimeve liberale dhe laike nga Perëndimi. Nga ana tjetër, kritikët thonë se partia në pushtet ka ndërmarrë sulme të pamëshirshme ndaj rendit kushtetues. "Votimi është për të mbajtur qeverinë dhe poli-

tikanët përgjegjës për premtimet e tyre. Jam i kënaqur për disa aspekte por jo me të tjerat. Gjithçka varet nga këndvështrimi", thotë votuesi Pawel.

Akuza më e rëndë përqendrohet te reformimi i sistemit të drejtësisë, që është kritikuar ashpër edhe nga Bashkimi Evropian dhe organizatat e të drejtave të njeriut.



NUK KANË TË NDALUR SUKSESET E UNIONIT NË GJERMANI

Në Munchen të Bavarisë, Unioni i bizneseve shqiptaro-gjermane, mbajti takim promovues me afaristët shqiptar të këtij regjioni nën organizimin e Ilir Sinanit, njëri ndër afaristët më të spikatur në Munchen.

Kryesise së Unionit në përbërje Gani Nuha Zenun Krasniqi Vllaznim Kelmendi, Bekim Bytyqi, Nexhmedin Veliqi dhe Bekim Borovci i priu kryetari i UB-së, Nazmi Viqa.

Të pranishëm në takim ishin edhe koordinorët, Besim Preniqi Faton Pllana, Besim Muzliu, Mufail Sinani Kujtim Metaj si dhe antari premium Bahri Tahiri.

Takimi rezultoi me antarësime të reja, ndersa koordinor për Munchen u zgjodh, zotëri Burim Hazrolli.



'Armagedoni' përuroi librat



Në Këndin e Bibliotekës "Nju Jork" të Kolegjit AAB, e në kuadër të Panairit Vjeshtor të Librit që organizon ky institucion i marrjes dhe i dhënies së dijes, në prani të studentëve, të studiuesve, artistëve, publicistëve, gazetarëve janë përuruar dy libra të Agron Shalës, "Andrra në beze" dhe "Korça sipas një kosovari" dhe libri më i ri i Adil Ollurit, "Kthimi i profetit", të cilët i ka botuar shtëpia botuese "Armagedoni". Drejtori i shtëpisë botuese "Armagedoni", i cili ka moderuar përurimin dhe ka folur për librat e dy autorëve, ka thënë se libri me tregime i Adil Ollurit, "Kthimi i profetit", i cili ka dalë nga shtypi në fillim të kësaj jave, do të ngjallë polemikë sapo të lexohet sepse do të mund edhe të keqkuptohet. Ai ka thënë se titulli i është vënë librit nga tregimi, ndoshta jo më i miri prej 18 sa janë gjithsej, por se është më i serti që gjendet brenda. "Autori i këtij libri, ashtu si në librat e mëparshëm me tregime, ngjarjet e tregimeve dhe të personazheve po vazhdon t'i zhvillojë në Kosovë, kurse temat e tyre t'i kalojë

përtej kufijve kombëtarë, duke dhënë dhe marrë dhe sjell në letërsinë shqipe prototipa të njerëzve nga religjioni, të cilët, ndër të tjera, bisedojnë me njerëz për jetën dhe për vdekjen, edhe për konceptet e trajtimit të tyre nga feja islame por, me paragjykimë". Sipas tij, me

këtë qasje të re letrare, Olluri, tregimet, për dallim nga të mëparshmit, botuar para disa vjetëve nga të tjerë botues, ka nisur t'i bëjë më joshës, më të ndjeshëm, më provokues për lexuesit sa duke gjuajtur yçkla në gojë dhe veprimet e personazheve komikë dhe tragjikë, po

aq duke ngrhur në majë të gjuhës dhe të veprimeve të tyre ironinë dhe sarkazmin, në pak raste edhe groteskun dhe alegorinë dhe duke mbushur gjuhën shqipe dhe të personazheve me ajete kuranore e me duva.

Gjatë prezantimit të librit të

Ollurit botuesi ka veçuar disa veçori të tregimeve dhe disa prej temave e motiveve të tregimeve. Së këndejmi, ai ka thënë se në 18 tregimet e tij, ani pse personazhet janë të ndryshëm e rrëfyeshi është një i vetëm që rrëfen kryesisht në vetën e tretë, në disa raste në të parën, duket sikur aty është vetëm një personazh e një narrator që shtegton nga njëri tregim në tjetrin, që hap tema me të njëjtën gjuhë bisedore e me fakte historike e që herë provokon pak e herë shumë, fenë islame, shtetin, pushtetin, të korruptuarit, kriminelët.

"Për fund, duke bërë një vëzhgim stilistik, shohim se në tregimet e Ollurit ende janë të pranishme dhe shumë të përdorshme paradoksi, alegoria, ironia, kundërthënia dhe kundërvënia e elementet fantazmagonike, kurse duket se ka hequr dorë nga fjalëformimi i kompozitave, nga fjalitë e gjata dhe i ka kushtuar kujdes më të madh shkrimit të gjuhës shqipe", ka thënë Armagedoni. Ndërsa autori i librit "Kthimi i profetit", Adil Olluri, tregoi se qëllimi primar i këtij libri ishte që ta krijonte një personazh të



e Shalës dhe të Ollurit



llojet e tjera të artit të kinematografisë dhe të letërsisë e të muzikës, duke paraqitur ndër-lidhjen e arteve, raportet e tyre e bërjen bashkë në një lloj. Esetë e këtij libri janë argumentuese. Kanë edhe poshtëshënime, kanë edhe shumë shpjegime për data dhe personalitete të kinematografisë, të letërsisë, të muzikës, të dramës.

'Andrra në beze' është një libër i mbushur me informacione të llojllojshme e të sakta, të verifikuara nga librat shkencorë, publicistikë dhe memoaristikë, për kulturën dhe njerëzit që e prodhuan atë dhe që lanë gjurmë të pashlyeshme në mendjen njerëzore dhe në arkivat e institucioneve", ka thënë Armagedoni për librin "Andrra në beze", kurse për librin tjetër "Korça sipas një kosovari" ka thënë se ky është "një reportazh



i gjatë, për njërin prej qyteteve më të bukura e më të kulturuar e të çmuara të Shqipërisë, për nismëtaresen e arsimit shqip, Korçën e Naimit e të rilindësve të tjerë, e cila u la mbresa të shumta edhe vizitorëve anglezë,

francezë, austriakë e kujt jo tjetër që e pati vizituar në vitet 1800 e 1900, saqë edhe e quajtn kryeqyteti i kulturës shqiptare. Unë nuk kam vajtur asnjëherë në Korçë por, shpresoj se do të shkoj një ditë atje, me Bedriun dhe

Agronin e ndonjë tjetër. Megjithatë, pa këtë guidë të Agronit për Korçën, pa përshtypjen e tij për qytetin e fshatrat e saj, pa i njohur ata miq të tij atje, s'do të doja të merrja rrugë asnjëherë. Jo, sepse, me këtë libër të Agronit për Korçën miqësohesh më lehtë me qytetarët e saj, edhe me ambientin e saj, edhe me natyrën e saj, edhe me objektet e saj. Nuk ka gjë që i mungon këtij libri. Ka fjalë të zgjedhura, ka rrëfime të vjetra, ka persona simpatikë e të dashur, ka fotografi të rralla e të vjetra. Ka një behane: veç që nuk flet". Për dy librat e vet ka folur edhe autori i tyre, Agron Shala. "Jam munduar që problematikën, realitetin tonë shqiptar, jo vetëm

në aspektin kulturor, por edhe në aspektin politik dhe sociologjik, ta ndërthur me shembuj nga e gjithë bota. Si pikënisje e kam marrë filmin. Dhe këtu janë 20 ese që si pikënisje i kanë 20 filma. Ndërsa 'Korça sipas një kosovari' është, sikurse tha botuesi, një guidë për këtë qytet, një tip monografie për Korçën", ka thënë Shala, duke veçuar se kosovarët me qytetarët e Korçës i bashkojnë më së shumti problemet politike.

Panairi Vjeshtor i Librit në Kolegjin AAB do të jetë i hapur edhe nesër (e shtunë) deri në orën 17.00, ndërsa të gjitha shtëpitë botuese pjesëmarrëse kanë ofruar zbritje në libra prej 20 deri në 70 për qind.

profetit i cili ishte më shumë sofist. "Qëllimi im primar ishte që ta krijoj një personazh të profetit që është më shumë sofist sesa të profetit i cili njihet dhe na jep religjioni islam. Edhe në fillim të tregimit kam shkruar se ky nuk është profeti që e gjeta mes jush, por e solla unë tek ju", është shprehur Olluri, duke shtuar se në shumicën e rasteve tregimet e tij kanë lindur në mënyrë spontane gjatë procesit të të shkruarit. "Shumë tregime në këtë libër kanë lindur spontanisht, gjatë procesit të të shkruarit. Shpeshherë ka ndodhur që, duke e shkruar një tregim, të më lindë ideja për një tregim tjetër", u shpreh autori Olluri.

Armagedoni ka përruar edhe dy librat e Agron Shalës, "Andrra në beze" (2018) dhe "Korça sipas një kosovari" (2019), për të cilët kritikët letrarë, regjisorët, dramaturgët, artistët, që me rastin e botimit të tyre, kanë shprehur fjalë miradije. Armagedoni ka bërë me dije se "Andrra në beze" është një libër me ese dhe me analiza për kulturën, veçan për filma dhe për muzikë. "Ia nis të lexosh për filma e autori të shëtite edhe në



E rrallë

Atleti i verbër hipën në çatinë e avionit për të protestuar

Një veprim ekstrem i cili krijoi panik në aeroportin e London City, në Londër. James Brown, ish-atlet paraolimpik i verbër, u zvarrit dhe u ngjit në çatinë e një avioni të British Airways, i cili ishte gatë për t'u ngritur. Qëllimi i atletit, aktivist i 'Extinction Rebellion', lëvizje globale që denoncon emergjencën ambientale, e bëri gjithçka kundër impaktit klimatik të fluturimeve. Pasi qëndroi një orë mbi avion, Brown u zbrit nga zjarrfikësit dhe u arrestua.



FOTO E DITES



Fëmijët e një shkolle indiane kanë veshur bluza me portretin e presidentit kinez Xi Jinping në prag të vizitës së tij në Chennai. /AP/

E jashtëzakonshme

Lopët pikturohen si zebra, arsyeja do t'ju habitë

Disa studiues japonezë vendosën që t'i lypnin lopët e zeza me vija të bardha si zebra për të parë se si ndikon kjo te mizat. Nga studimi u vërejt se lopët me vija të bardha kishin prani më të ulët të mizave dhe pickimeve prej tyre sesa lopët e zeza.



BARSOLETA E DITËS



Babai: Si kalove në shkollë sot?
Djali: Mirë.
Babai: A e përmirësove notën në matematikë?
Djali: Jo.
Babai: Pse?
Djali: Sepse ngado që po shkon profesori po e merr dëtarin me vete.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;
1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Miqtë dhe partneri/partnerja mund të përfitojnë nga mirësia juaj.



DEMI

Anëtarët e familjes mund të kenë shumë gjëra në mendje sot dhe mund t'ju kërkojnë më shumë ndihmë se sa mendonit.



BINJAKËT

Sot mund të kaloni kohë duke ndihmuar motrën/vëllanë ose një mik për një udhëtim që duan të bëjnë.



GAFORRJA

Dikush mund të tërheqë vëmendjen tuaj duke ju folur për investime.



LUANI

Sot mund të ndiheni sikur po mbusheni me energji fizike.



VIRGJËRISHA

Përgjegjësitë mund të jenë në mendjen tuaj sot.



PESHORJA

Sot do keni shumë energji krijuese dhe jeni gatë për të punuar në një projekt.



AKREPI

Sot mund të jeni në qendër të vëmendjes. Keni kujdes me miqtë tuaj.



SHIGJETARI

Keni shumë telefonata për të bërë? Është ditë e hënë, por do ju duket si e martë nëse merreni me punë.



BRICJAPI

Shpenzimet e papritura, mbase për riparimet e shtëpive, mund të kërkojnë para.



UJORI

Ajo çfarë nuk ju pëlqen tek partneri/partnerja do ju japi një gjendje psikologjike të mërzitur.



PESHQIT

Festat e mëdha mund t'ju lodhin. Ushqimi dhe pija mund të kenë qenë të shkëlqyera, por sot duhet të zgjidhni ushqimin që më të shëndetshëm.

Kimi bën fotografi familjare në tempullin Garni



Kim Kardashian ka shijuar një vizitë shpirtërore dhe plot atraksion në atdheun e vet stërgjyshor të Armenisë këto ditët e fundit. Ajo po sigurohet që kurrë nuk do ta harrojë aventurën speciale. Ylli


televiziv organizoi një fotosesion në tempullin historik Garni me familjen e saj. Ishte dita e fundit e udhëtimit të Kimi, kështu që pa dyshim që ajo ishte e prirë të bënte disa fotografi për ta kujtuar rastin.

Fotografite që s'i keni parë nga dasma e Haileyit dhe Justinit



Ata i thanë po njëri-tjetrit për herë të dytë në fund të muajit të kaluar. Tani fotografite e reja nga ceremonia e mbushur me vje të Hailey dhe Justin Bieberit

janë publikuar në rrjetet sociale. Modeluesja 22-vjeçare dukej sikur po kalonte kohën e jetës së saj në fotografi që shfaqnin veshjen e saj Vera Wang në dasmë.



Martohet producenti i njohur Paul DiGiovanni

Producenti muzikor Paul DiGiovanni dhe aktorja amerikane Katie Stevens janë martuar të shtunën para 250 miqve dhe familjarëve. Sipas "People", Stevens ka pohuar se që nga momenti i parë kur është

takuar me Paulin e ka ditur se me të do të martohet. "Takimi ynë i parë i dashurisë ishte para pesë vjetëve. Që nga momenti i parë kur e kam takuar dhe deri tani ai më ka bërë mua të ndihem çdoherë e veçantë", ka thënë Stevens.

Miley Cyrus e takon të dashurin e ri me nënën



Këngëtarja e njohur Miley Cyrus është në lidhje të re të dashurisë me muzikantin australian Cody Simpson. Cyrus të

dashurin e ka takuar edhe me nënën e vet Tish. Sipas "People", ata janë parë bashkë duke pirë kafe në lagjen Toluca Lake të Los Anxhelosit.

EUROGLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Challandes dhe Rashica: Duhet ta mposhtim Malin e Zi

Trajneri Bernard Challandes dhe futbollisti Milot Rashica kanë shprehur optimizëm një ditë para ndeshjes me Malin e Zi, e cila zhvillohet sonte në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 20:45. Ata kanë paralajmëruar se kërkojnë tri pikë të reja për ta vazhduar rrugëtimin drejt kualifikimit historik në Kampionatin Evropian



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e hënë) nga ora 20:45 përballë me Malin e Zi në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian "Euro 2020". Trajneri Bernard Challandes ka thënë se tash për tash nuk po mendon për Ligën e Kombeve apo humbjen e Anglisë nga Çekia, por vetëm për ndeshjen që "Dardanët" e zhvillojnë ndaj malazezëve. Strategu zviceran kërkon fitore në këtë përballje në mënyrë që Kosova ta vazhdojë rrugëtimin drejt kualifikimit në "Euro 2020". "Tani për tani nuk po mendoj për Ligën e Kombeve, pasi kemi një ndeshje nesër kundër Malit të Zi. Për mua s'ka ndryshuar asgjë përkundër fitores së Çekisë. Është më vështirë, por nuk mendoj për ndeshjet e radhës. Nëse Anglia do të kishte fituar në Çeki edhe barazimi do të na kishte hyrë në

punë. Por, sido që të jetë, ne shkojmë ndeshje pas ndeshje dhe duhet të fitojmë atë të radhës kundër Malit të Zi. Në fund të kualifikimit, nëse nuk është siç kemi menduar, atëherë kemi opsionin tjetër", ka thënë Challandes.

Për ndeshjen ndaj malazezëve foli edhe anëtori Milot Rashica i cili mungoi në ndeshjet e kaluara si pësojë e një lëndimi. Ylli i skuadrës gjermane Werder Bremen ka thënë se hyjnë në secilën ndeshje për fitore. "Besoj se deri tash kemi bërë rrugëtim shumë të mirë dhe të gjithë lojtarët kanë marrë përvojë të mirë. Ne hyjmë në çdo ndeshje për fitore. Shpresojmë të fitojmë qysh nesër e më pas të koncentrohemi për ndeshjen e radhës. Ne kemi besuar nga fillimi, prej kur kemi parë grupin, pas çdo ndeshje kemi pasur besim për ndeshjen e radhës. Gjithçka është e mundshme", ka thënë Rashica.

Ndërsa për Malin e Zi është

paraqitur sulmuesi me prejardhje nga Peja, Fatos Beqiraj. Ky i fundit bëri me dije se malazezët, edhe pse nuk kanë pasur rezultate të mira në kualifikuese, do të mundohen që nga kjo ndeshje t'u rikthehen fitoreve. Beqiraj e ka lavdëruar Kosovën, duke thënë se ka lojtarë shumë të mirë dhe ata janë me plot optimizëm për të arritur suksese. "Shpresoj se kjo të ndryshojë duke filluar nga Kosova, së paku të luajmë më mirë se ndaj Bullgarisë. Kosova ka një skuadër të re, me shumë lojtarë të mirë, të cilët luajnë në klube të mira. Ekipi i tyre ma përkujton skuadrën tonë para shtatë-tetë vjetësh, kur stadiumi ishte plot, përplot optimizëm dhe dëshirë për t'u treguar. Nuk them se tash na mungon dëshira, ne luftojmë dhe duam fitore, por po kalojmë nëpër një periudhë të vështirë. Shpresoj që së shpejti, duke nisur që nga ndeshja ndaj Kosovës, të tregojmë imazh tjetër", ka thënë Beqiraj.

Kosova renditet në pozitën e tretë në Grupin A me 8 pikë, kurse Mali i Zi është në pozitën e katërt me vetëm 3 pikë.

Shqipëria synon t'u rikthehet fitoreve ndaj Moldavisë

Sonte ndeshjen e radhës kualifikuese e zhvillon edhe Kombëtarja e Shqipërisë në futboll. Kuqezinjtë pësuan humbje të papritur të premtën në ndeshjen ndaj Turqisë (1-0), ku një moskoordinim i mirë në mes të portierit Strakosha dhe mbrojtësit Ismajli bëri që turqit ta shënojnë golin e fitores. Tash Shqipëria do të luajë sërish mysafire, por ndaj një kundërshtari më të lehtë siç është Moldavia. Kombëtarja shqiptare synon tri pikët nga kjo ndeshje, ani pse kualifikimi duket një mision i vështirë për t'u arritur. Aktualisht shqiptarët zënë

vendin e katërt me 9 pikë, kurse Moldavia është e fundit me vetëm tri pikë të grumbulluara.

GRUPI A

20:45 Bullgari - Angli
20:45 Kosova - Mali i Zi

Tabela		PIKË
1. Anglia	5	12
2. Çekia	6	12
3. Kosova	5	8
4. Mali i Zi	6	3
5. Bullgaria	6	3

GRUPI H

20:45 Franca - Turqia
20:45 Islanda - Andorra
20:45 Moldavia - Shqipëria

Tabela		PIKË
1. Turqia	7	18
2. Franca	7	18
3. Islanda	7	12
4. Shqipëria	7	9
5. Andorra	7	3
6. Moldavia	7	3

SHKURT

Kosova shënon fitore historike në botëror të kërlingut

Përfaqësuesja e Kosovës në kërling ka shënuar fitoren e parë në histori të saj në kampionatin botëror të kërlingut për mikse që po mbahet në Aberdeen të Skocisë. Kombëtarja jonë mposhti Nigerinë 9:3, e cila, po ashtu, debutoi në këtë botëror. Garuesit Mirjeta Shatri, Erik Shabaj, Eldena Dakaj dhe Peter Andersen po e përfaqësojnë Kosovën bashkë me trajnerët Meriton Zeneli dhe Judy Russell. Dje garuesit tanë humbën takimin me Sllovakinë, me rezultat zyrtar, pasi shkaku i problemeve me vizë arritën me vonesë në Skoci. Krahas Sllovakisë e Nigerisë, në grup me Kosovën janë edhe Kanada, Bjellorusia, Estonia, Gjermania dhe Hong Kongu.

Berisha debuton me gol

Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Besart Berisha, e ka nisur aventurën e tij të re në Australi, te klubi Western United, në mënyrën më të mirë. 34-vjeçari në ndeshjen e tij të parë me skuadrën australiane ka shënuar gol në minutën e 34-t. Ky gol i dha fitoren e ekipit të tij në ndeshjen nga Wellington Phoenix, që përfundoi me rezultatin 0-1.

Favoritët nuk gabojnë në hendboll

Rezultate të pritura janë shënuar të shtunën kur janë luajtur tri ndeshje të javës së tretë të Superligës së hendbollistëve. Kampioni aktual, Besa Famgas, ka fituar ndaj Vëllaznimit në Gjakovë me rezultat bindës 40:21. Për Besën ishte fitorja e tretë në tri takime të

luajtura. Gjashtë pikë i ka edhe Prishtina, që të shtunën fitoi në Prizren ndaj skuadrës së Prizrenit me rezultat 36:27. Fitore si vendës ka shënuar vetëm Drenica. Drenica në Drenas e mposhti Llapin me rezultat 32:26. Ndeshja në mes të Dritës e Kastriotit është shtyrë për të martën me kërkesë të Kastriotit dhe me marrëveshje të dy klubeve.

Liburni eliminohet nga Liga e Kampionëve pa asnjë humbje

Skuadra kampione e Kosovës në futboll, Liburni nga Gjakova, e ka mbyllur ciklin kualifikues në UEFA Futsal Champions League, që u mbajt në kryeqytetin bjellorus, Minsk. Liburni ishte i përfshirë në Grupin 7 së bashku me Stalitska Minsk, Toulon Elite dhe Hovocubo. Në të tria ndeshjet ekipi gjakovar bëri paraqitje shumë të mira dhe arriti barazime, por në fund u eliminua, duke e mbyllur këtë fazë të kualifikimeve në pozitën e tretë.

Fitore bindëse nga Peja dhe Prishtina

PEJE, 13 TETOR - KB Peja dhe KB Prishtina kanë shënuar fitore bindëse në shtëpi ndaj Lipjanit, përkatësisht Feronikelit. Pejanët kanë arritur që të shënojnë fitore në ndeshjen e javës së pestë ndaj Lipjanit.

Ndeshja e zhvilluar në palestrën 'Karagaçi' përfundoi me rezultatin 96:82. Te vendasit më të dalluarit ishin Jamicheal Morgan me 22 pikë dhe Jordan Martin 20 pikë. Ndërsa, te mysafirët me pikë më të dalluarit

ishte Demarkus Stutckey Jr me 38 pikë. Në ndeshjen tjetër basketbollistët e Sigal Prishtinës kanë shënuar fitore kundër Feronikelit me rezultat 102:69 (32:16, 24:19, 27:13, 19:21) në kuadër të xhiros së pestë në

Superligën e Kosovës. Më të merituarit për triumfin e Prishtinës ishin Dardan Berisha me 26 pikë dhe Jonathan Wade me 24 pikë. Te Feronikeli më të dalluarit ishte Tyrone Garland me 24 pikë.



Ronaldo flet për karrierën tek Interi: Asnjëherë s'e kisha menduar largimin

MILANO, 13 GUSHT - Luiz Nazario Da Lima, apo i njohur nga të gjithë si Ronaldo, është rikthyer të flasë për përvojën tek Interi dhe datën 5 maj të vitit 2002, ku zikaltrit humbën titullin kampion vetëm në javën e fundit pas një disfatë në "Olimpico" ndaj Lazios. "Titulli kampion i humbur me Interin në 2002-shin ishte një nga zhgënjimet më të mëdha të karrierës sime dhe nuk mbaj mend të kem qarë aq shumë me të tjera skuadra. Kishte shumë pritshmëri nga tifozët, pas shumë vitesh që fitohej nga Juve, në mënyrën si fitonte ajo", ka thënë Ronaldo. "Fenomeni" mundohet t'i gjejë shkaqet e disfatës 4-2 në "Olimpico" ndaj Lazios dhe thotë se ndeshja u përgatit në një atmosferë të keqe dhe se trajneri Hector Cuper kishte gabuar në ndërtimin e formacionit në takimin vendimtar. "Gjatë gjithë javës kishte zëra që do ta blinin Nestën dhe që ai nuk do të luante më 5 maj. Ndeshja u përgatit në një atmosferë aspak të qetë, ndonëse ishim të bindur që do të fitonim. Pastaj gaboi



edhe Cuper me formacionin, duke hedhur një mesfushor më tepër në fushë", shprehet braziliani. Ajo ishte edhe ndeshja e fundit e Ronaldos me fanellën e Interit, sepse më pas erdhi Botërori i futuar me Brazilin si protagonist dhe në verë transferimi te Reali i Madridit, ndërsa fenomeni zbulon edhe prapaskenat e largimit nga klubi zikaltrë. "Nuk e kisha menduar asnjëherë largimin nga

Interi, pasi e shihja klubin si shtëpinë time për gjithë jetën, por me Cuperin nuk po ia dilja dot, sepse tjetër gjë më thoshte dhe tjetër gjë bënte. I shkova Morattit në zyrë dhe i kërkova të zgjedhë mes meje dhe Cuperit, i bindur se ai do ta shkarkonte trajnerin. Megjithatë, në fund u befasova, pasi presidenti zgjodhi ta mbajë trajnerin dhe më pas për krenari vendosa të largohem", ka shtuar Ronaldo.

SHKURT

Barça mendon për zëvendësuesin e Suarezit

Skuadra e Barcelonës ka filluar të mendojë për zëvendësuesin e Luis Suarezit, i cili dalëngadalë ka filluar të ketë rënie të formës, por edhe lëndime të shpeshta si pasojë e moshës. "Mundo Deportivo" raporton se gjigantët spanjollë kanë në listë katër emra mjaft të fuqishëm në botën e futbollit. I pari në listë është sulmuesi i Paris Saint-Germainit, Kylian Mbappe, pas tij renditen Harry Kane (Tottenham), Marcus Rashford (Manchester United) dhe Lautaro Martinez (Inter).

Klose: Lewandowski, dhjetë herë më i mirë se unë

Sulmuesi i Bayern Munichit dhe Polonisë, Robert Lewandowski, e ka nisur me shifra të frikshme sezonin e ri. 31-vjeçari ka shënuar 18 gola në këto javë të para me klubin dhe kombëtaren. Një ecuri për të cilën polaku ka marrë komplimentet e njërit që e njeh shumë mirë "zanatin" e shënimit të golave. Ai është Miroslav Klose, ish-sulmuesi i Gjermanisë dhe Bayernit. "Ai është dhjetë herë më i mirë se unë", ka thënë Klose për "Sport Bild". "Ka një stil të ngjashëm loje me mua, por është 10 herë më i mirë se unë. Është një sulmues i plotë, i përdor të dyja këmbët, është i fortë me kokë dhe ka një goditje shumë të mirë", ka shtuar Klose.

Boksieri pas nokautit përfundon në koma

Patrick Day është dërguar me urgjencë në spital pas humbjes kundër Charles Conwell në meçin e kategorisë super të mesme të dielën. Dayn u desh ta largonin nga ringu në barelë pas nokautit që e pësoi në raundin e 10. Sipas televizionit që e transmetoi meçin, DAZN, boksieri amerikan është në kujdes intensiv pasi kishte pësuar sulm pas nokautit. ESPN raporton se 27-vjeçari i është nënshtruar një operacioni emergjent në tru.

Maguire: Anglia humbi si pasojë e formës së klubeve

Mbrojtësi i Manchester Unitedit, Harry Maguire, ka zbuluar arsyet që Anglia humbi ndeshjen kundër Çekisë. Kombëtarja e Anglisë është mposhtur për herë të parë në 10 vjetët e fundit në një ndeshje eliminatorë, në ndeshjen e luajtur në Pragë. "Ne kemi sjell nivelin tonë të futbollit në klube te kombëtarja. Ishte ndeshje e vështirë", ka thënë Maguire, duke insistuar se forma e dobët me klubet ka ndikuar te kombëtarja. "Në pjesën e dytë kontrolluam ndeshjen më shumë se në të parën, por ne pranuan dy gola të lehtë dhe ata fituan ndeshjen. Duhet të përmirësohemi" ka shtuar Maguire.

Mançini, pas kualifikimit në 'Euro 2020': Falënderoj tifozët për përkrahje

Roberto Mançini është ndarë i kënaqur me paraqitjen e Italisë dhe përkrahjen e tifozëve vendës në fitoren 2-0 ndaj Greqisë në kuadër të ndeshjeve eliminatorë të Grupit J. "Azzurrët" kanë fituar të shtatë ndeshjet e luajtura në Grupin J dhe janë kualifikuar në "Euro 2020", diçka që Italia nuk e ka arritur kurrë më parë. "Djelmshat bënë vërtet mirë. Para së gjithash, dua t'i falënderoj tifozët në 'Olimpico' që dolën dhe na përkrahën, edhe pse në pjesën e parë ishim pak të tensionuar, mbase nervoz për rikthimin në Romë", ka thënë fillimisht Mançini.

"Ne donim t'ua kushtonim fitoren fëmijëve në spitalin e fëmijëve. Ne do të takojmë ekipe që ulen dhe mbrojnë. Ishim shumë të furishëm në pjesën e parë, por duhej ta kishim lëvizur me durim topin për të krijuar hapësira. Përkundrazi, filluam me topa të gjatë dhe kjo nuk është mirë. Pjesa e dytë ishte shumë më e qetë, ne vazhduam të përqendruar dhe arritëm objektivin tonë. Ishte e mrekullueshme ta shohësh 'Olimpicon' dhe shpresojmë se do të jetë edhe më mirë qershorin e ardhshëm", ka deklaruar Mançini.

Bottas triumfon në Suzuka, Mercedesi siguron titullin kampion

SUZUKA, 13 TETOR - Valtteri Bottas është fituesi i çmimit të madh të Japonisë në Botërorin e Formulës 1. Piloti finlandez shfrytëzoi fuqinë e makinës së tij dhe gabimet e Ferrarit në startin e garës duke regjistruar fitoren e tretë sezonale të tij, duke lënë në vendin e dytë Sebastian Vettelin dhe në të tretin Lewis Hamiltonin, një rezultat ky që i jep mundësinë Mercedesit ta fitojë titullin e 6 radhazi botëror për konstruktorë. Kjo fundjavë nuk ishte aspak e zakonit për Formula 1 që i zhvilloi provat zyrtare këtë të diel, pak orë përpara fillimit të garës për shkak të tajfunit 'Hagibis' që goditi brigjet japoneze ditën e shtunë. Në këto kualifikuese ishin pilotët e Ferrarit me Sebastian Vettelin që fitoi pole position duke lënë në vendin e dytë Charles Leclerc. Por pilotët e Kokëkuqes e kompro-



mentuan fillimin e garës. Sebastian Vetteli gaboi në startin e tij dhe komisarët e garës nuk e ndëshkuan gjermanin që gjithsesi u parakalua nga Valtteri Bottas që e nisi garën nga vendi i tretë. Gjithsesi Vetteli arriti t'i rezistojë Lewis Hamiltonit me britanikun që u mjaftua me vendin e tretë dhe që po shkon drejt titullit të 6 të tij për pilotë. Për sa i përket Charles Leclerc, piloti nga

Monaco u përfshi në një aksident në kthesën 1 të pistës me pilotin e Red Bullit, Max Verstappen, që më pas u tërhoq nga gara. Leclerc u detyrua të hyjë në bokset e Ferrarit për ta mbyllur garën në vendin e gjashtë. Nga gabimet e Ferrarit përfitoi Alex Albon i renditur në vendin e katërt duke regjistruar kështu rezultatin më të mirë të karrierës së tij duke lënë pas Carlos Sainz.



Autor: GAZMEND MORINA	AKTORI AMERIKAN NË FOTO	JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHITJE TË DREJTËSISË	JEVG	IVAN KLASNIÇ	KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA	KRYENGRITË- SI QË DILTE MALIT E LUFTONTE MINDERI I ULËT (vjet.)	IVREA	EPOKA E RE	BIMË SHUMËVJE- ÇARE ME TRUNG TË TRASHË	LLOJ BIME NARKOTIKE
ZËRI I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT								DY BASHKË- TINGËLLORE DRAMË E SANTORIT		
NGJALLJA E KUJTIMEVE PËR DIKË							EPOKË (shq.)			
KANUN, LIGJ (vjet.)				AKTROJA AMERIKANE BASINGER SHTET I MADH NË AZI			SEKRETARI I OKB-së BAN KI QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP (për kafshët)			
ALFRED KAÇINARI			GJAKATARI BIXHOZ					ZANORE MALI MË I LARTË NË TURQI		
NJERI I VARFËR QË ËSHTË PËR T'U MËSHIRUAR (shq.)						BANORI I ARABISË SAUDITE VARGU I KURANIT				
						BUJKU KËNGËTARJA BERISHA				
KËNGËTARJA SEJDIU ZANORE		NËNA VEPRIMTARI ZEZAK MARTIN KING						ANTIGONA SEJDIU OLIVIER MARTINEZ		
EPOKA E RE	DIÇKA QË BURON NGA DIÇKA TJETËR	I SPËRKATA ME UJË	BOKSIERI I NJOHUR KLITSCHKO	"Z" në mes të dy "A"	PAKTI USHTARAK MË I MADH NË BOTË	UÇK (ang. origj.) IDRIZ BALAJ	REGJISORI ... QOSJA	TËRËSIA E ORENDIVE SMIRA		
KANAPE E GJERË DHE E GJATË SI SHTRAT (shq.)						PËRGËZIMET SHTET (FR.)		MIMOZA AHMETI AKTORJA AJETI		AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS
AKTORJA E FAMSHME ANGLEZE HURLEY (shqip.)						KËNGËTARI ARIFI ENË E METALTË PËR TË SKUQUR VAJIN		TONI ADAMS QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE		
KËSTET BANKARE PËR KTHIMIN E KREDISË					GRADE USHTARAKE QË KA TË BËJË ME FSHATIN		REGJISORI ... HALILI PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE			
				KOHA E NDARË PËR PUNË POLITIKANI FERID			JETËSHKRIM ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHEARER (origj.)		ARMENIA UNITED PROGRESIVE ALLIANCE	
SHIU I IMËT DALLGA					UMA TURMAN AKTORI EGJIPTIAN SHARIF	BISHTUK ME VAJGURI (shq.) QË KA MBUSHUR NJË VIT, MOTAK				PRAPË
ARTANA		ISH MUZIKANTI RUS STRAVINSKI GDHENDUR, LATUAR				PYLLI PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)		I ÇELA ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER		
DY BASHKË- TINGËLLORE			FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ (mit greke) POROSIA E FUNDIT				MA JEP INSTITUCION I LARTË SHKENCOR	AGIM POSHKA KALI I SHALËS		
EPOKA E RE	HENDEK PËR TË UJITUR (sh.shq.) LLOJ SHALE DRURI						ANIJATA HARAÇ		ZANORE ALBANOLOGIA DURHAM	
FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI (MANCHESTER CITY)						SHEGË LUMË NË SHQIPËRI	BRINJËT QË FORMOJNË KËNDIN E DREJTË TË TREKËNDËSHIT SHEJTAN			
ALUMIN, AMPER			KLUB FUTBOLLI NË GREQI	PAJISJA E VETURËS SË LËSHON TINGUJ REOMIR, INDIUM			OSAKA RROGË VJETORE E PAPËS	IVAN DIXON QË I PËRKET ETIKËS		BALTA E QULLËT, GJANA
KULLË E XHAMISË						SHKRIMTARI ISMAIL STUDENT AID REPORT		IGLESIA GABRIEL NJËSI E VJETËR PESHE		
ZBRITJE E AEROPLANIT NË TOKË						ELEMENT KIMIK (SE)		FUTBOLLISTI FRANÇESKO (ROMA) TITAN		
PUNA E PËRDITSHME, ZAKONISHT E MËRZITSHME, PA ASNJË NDRYSHIM						ATEMOR, JO TEMATIK ZANORE			BASHKËT. KRUJA	
REGJISORJA ELEZI				HIJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE		LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE				



Nr.ref.: 3553/19
Datë: 11/10/2019

Senati i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), në mbledhjen e mbajtur me 11.10.2019 mori vendim që të shpall:

KONKURS PLOTËSUES
për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2019/2020

- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për studimet postdiplomike – master për vitin akademik 2019/20 do të regjistroj 92 studentë.
- Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij konkursi, duke u bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHT-it, Universiteti do të regjistroj deri në 12%, përkatësisht deri 18 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti joshumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve vec e vec.
- Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci, Medvegja deri 2% përkatësisht 3 studentë, si dhe 2%, përkatësisht 3 studentë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria dhe 1% përkatësisht deri 3 kandidatë nga Mali i zi. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuara, ndërsa studimet i kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.

I. KUSHTET E PËRBASHKËTA TË KONKURISIT

- Në studimet post diplomike – master në UShAF mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha Institucionet e Akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta përparësi në pranim do të kenë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet themelore – Bachelor në UShAF.
- Të drejtë pranimi në UShAF kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës.
- Të drejtë konkurimi kanë të gjithë kandidatët që kanë mbaruar studimet themelore- bachelor në fushat e studimit të përafërta në fakultetet, përkatësisht programet si në vijim:
 - Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit**
Programi: Arkitekturë dhe Dizajni i Interierit me prodhime nga druri
 - Fushat e studimeve bachelor (themelore): Arkitekturë; Dizajni; Përpunim i Drurit; Inxhinieri e Ndërtimit dhe në fushat e përafërta.
 - Fakulteti i Inxhinierisë me Informatikë**
Programi: Inxhinieria dhe Informatika
 - Fushat e studimeve bachelor (themelore): Inxhinieri Mekanike; Inxhinieri Elektrike dhe në fushat e përafërta.
 - Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit**
Programi: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm
 - Fushat e studimeve bachelor (themelore): Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit; Ekonomi; Menaxhment dhe të përafërta.
- Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të UShAF, nuk kanë të drejtë konkurimi në program tjetër studimi në UShAF pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u regjistruar nga programi aktual i studimeve.
- Kandidatët për pranim si studentë në UShAF në vitin akademik 2019/20 nuk mund të konkurojnë më shumë se në një fakultet apo program të studimit.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

- Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim: Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë dhe atë:
 - Suksesi në studimet themelore deri në 50 pikë;
 - Pikët nga lëndët prioritare (5 lëndë) deri në 50 pikë.
- Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të lëndëve prioritare, e nëse edhe pikët e lëndëve prioritare janë të njëjta atëherë do të mirret parasysh suksesi i studimeve themelore Bachelor. Nëse edhe suksesi është i njëjtë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femrore. Në qoftëse kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.
- Për funksionimin e programit studimor të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 10 studentëve.

III. AFATET E KONKURISIT

- Për aplikimin, regjistrimin dhe fotografimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master, oraret do të jenë si në vijim:
- Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 14.10.2019 deri më 21.10.2019 në ora 16:00 (dokumentet do të pranohen edhe ditëve të shtuna).
- Ditën e parë të konkursit me datë 14.10.2019 aplikimi online do të funksionalizohet nga ora 10:00, ndërsa pranimi i dokumentacionit në njësitë akademike do të filloj nga ora 11:00
- Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet të i sjellin këto dokumente:
 - Fletëparaqitja e plotësuar, e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: linku për aplikim online përmes internetit është www.ushaf.net/apliko
 - Ekstraktin e lindjes origjinal

- Diplomën ose certifikatën e diplomimit orgjinale ose të noterizuara
- Dëshminë e akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë
- Çertifikatën e notave (Bachelor)
- Çertifikatën e njohjes së gjuhës angleze në nivelin A1 sipas UA 3/2018 (përkatësisht TOEFL TEST)
- Për kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit duhet të sjellin vendimin e nostrifikimit
- Kandidatët me rastin e aplikimit paguajn 2.50 € (fletëpagesa shkarkohet nga interneti me rastin e aplikimit).

- Kandidatët e pranuar me rastin e regjistrimit të semestrit do të paguajnë tarifën e shkollimit sipas UA 17/14 të datës 06.05.2014.
- Shpallja e rezultateve preliminare bëhet më së voni, deri më 22.10.2019, ndërsa rezultatet përfundimtare shpallen 24.10.2019 në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqen e Universitetit

IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve master, mund të ankohen kundër vendimit pas shpalljes së rezultateve, përkatësisht me datë 23.10.2019 nga ora 8:00- 16:00 në Administratën Qendrore. Vendimin përfundimtar rreth ankesës merret nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave.

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i terhekin dokumentet e tyre në Administratën Qendrore të UShAF me datë 29.10.2019

V. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

- Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit me datën 25.10.2019 dhe 28.10.2019
- Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përfunduar në momentin e fotografimit.
- Nëse kandidati i pranuar nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit. Vendet e mbetura vakant, pas humbjes së të drejtës së regjistrimit, përkatësisht lëshimit të afatit si në paragrafin 3 të kapitullit V nuk do të zëvendësohen me kandidatë të cilët gjenden në listën e kandidatëve të pa pranuar.

VI. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

- Fletëregjistrimin të plotësuar (i cili shkarkohet nga SMU)
- Dy fotografi të formatit 6x4 cm
- Fletëpagesën e cila shkarkohet nga interneti në shumën prej 150 € për një semestër pagesa bëhet në njërin nga bankat afariste

Për informata të tjera të nevojshme, kandidatët duhet të i drejtohen Administratës Qendrore ose të hapin faqen e internetit www.ushaf.net

I. UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Në vitin e parë të studimeve master do të regjistrojë 92 studentë në fakultetet si në vijim:

Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga Mali i zi	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja	Kandidatë nga Shqipëria dhe Maqedonia	Gjithsej
Programi		1%	12%	2%	2%	
Gjithsej	65	3	18	3	3	92
Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit	28	1	6	1	1	37
Programi: Arkitekturë dhe Dizajni i Interierit me prodhime nga druri	28	1	6	1	1	37
Fakulteti i Inxhinierisë me Informatikë	27	1	6	1	1	36
Programi: Inxhinieria dhe Informatika	27	1	6	1	1	36
Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	10	1	6	1	1	19
Programi: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm	10	1	6	1	1	19

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare dhe lëndëve prioritare sipas programeve në vijim:

Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit

Programi: Arkitekturë dhe Dizajni i Interierit me prodhime nga druri

- Cad
- Bazat e Dizajnit
- Dizajni i Interierit
- Dizajni i Mobileve
- Materialet me Bazë druri

Fakulteti i Inxhinierisë me Informatikë

Programi: Inxhinieria dhe Informatika


- Matematikë
- Programim
- Teknologjia e Përpunimit të Materialeve Polimere
- CAD
- Materialet Inxhinierike

Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit

Programi: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm

- Bazat e Ekonomisë
- Bazat e Kontabilitetit
- Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri
- Hyrje në Turizëm
- Turizmi i Qëndrueshëm

U bënë 11 vjet nga ndarja e më të dashurit tonë



Milaim H. Misini

(20.04.1938-13.10.2008)

Vdekja të ndau nga Jeta, por jo nga zemrat tona.

Ishe bashkëshort, baba, vëlla, gjysh e vjehërr shumë i dashur.

E përkujtojnë: Familja Misini nga Prishtina dhe Korretica e Ulët.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC COLA
Columbus, Georgia, USA
Since 1909